

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 237, Korrik 2023

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Festa e Alpeve -2023

TRAGJEDI TJETËR DUKAGJINASE

- Me rastin e vrasjes së 57-vjeçari Gjakë Gurra dhe djali i tij Eduart Gurra, rreth 30 vjeç -

Me 29 qershor 2023, ditë e Enjte, rreth orës 16. 40, në fshatin Sumë, Njësia Administrative Pult, në rrethana të paqarta janë vrarë me armë zjarri 57-vjeçari Gjakë Gurra dhe djali i tij Eduart Gurra, rreth 30 vjeç.

Ike fizikisht, por drita jote do të ndriçojë gjatë

Prof. dr. Vehbi Hoti-mishërim i humanistit e mendimtarit pedagogjik

Shtatori i viti 1971 ka qenë për mua një ndër momentet më të rëndësishme të jetës sime-fillimi i studimeve në Institutin e Lartë Pedagogjik-Shkodër (sot, Universiteti "Luigj Gurakuqi"), në një qytet me tradita të shkëlqyera, në arsim e kulturë, me personalitete të shquara në shkencë, në art, në sporte, në muzikë, në letërsi e të tjera.- me një traditë të pasur të shquar e prurje bashkëkohore cilësore, të cilat me e të vona.

Luigj Shyti, poet, studiues e publicist

Luigj SHYTI, lindur më datën 23 mars 1948, i biri i Gjergjit dhe Ages, në fshatin Theth, të krahinës së Shalës, Dukagjin, .

Është fëmija i parë, prej shtatë fëmijësh i kësaj familje, dy djem e pesë vajza. Të gjithë janë të martuar, dhe kanë krijuar familjet e tyre.

Është nga një familje fshatare e thjeshtë, por, si degë pasardhëse e shtëpisë së përmendur të Lul Gjakës së Gjellave të Thethit.

U rrit në Theth dhe punoj në ... dhe në krahinat e fshatrat...



Përkujtohet 108 vjetori i tribunit të lirisë Mehmet Shpendi (Nderi i Kombit)

108 vite më parë historia fliste ndryshe. Ballkani ziente nga lufta, Dukagjini mbronte me gjak pragun e shtëpisë, trimat e trimëreshat flijoheshin për liri.

Në ato dite të përgjakura të korrikut 1915, Plani dhe Gjurajt i dhuruan lirisë 72 dëshmor të pafajshëm, Shala flijoj tre nga prijësit e saj legjendar me në krye t'parin e Djemnis Mehmet Shpendi dhe në gjithë Dukagjinin u flijuan 106 dëshmorë.

Në këtë përvjetorin qëndrese dhe lavdie, sot Shoqata Atdhetare "Dukagjini" vendosi kurora dhe organizoj një veprimtari përkujtimore pranë trupores së Mehmet (Sokol) Shpendit.

Reportazhin e kësaj veprimtarie më shumë e përcjellim me foto, por për kujtesë dhe ne respekt të këtij emri të madh, po paraqesim pak histori.

Truporja e Mehmet Shpendi është një skulpturë e derdhur në Bronzë nga Skënder Kraja, ...



TRAG JEDI TJETËR DUKAGJINASE

- Me rastin e vrasjes së 57-vjeçari Gjokë Gurra dhe djali i tij Eduart Gurra, rreth 30 vjeç -

Me 29 qershor 2023, ditë e Enjte, rreth orës 16. 40, në fshatin Sumë, Njësia Administrative Pult, në rrethana të paqarta janë vrarë me armë zjarri 57-vjeçari Gjokë Gurra dhe djali i tij Eduart Gurra, rreth 30 vjeç.

Nga një mendje e ftohtë dhe dora e një njeriu vriten dy persona, babe e bire, dy prind, Gjokë Gurra e Eduart Gurra, lindur e rritur në fshatin Sume, të krahinës së Pultit, banues në qytetin e Shkodrës.

Me datën 1 korrik 2023, dite Shkurt, rreth orës 16.00 u përcollën për në banesën e fundit nga qindra njerëz.

U vranë dy NJERËZ, në kulmin e moshës së pjekurisë, mbeten pa ta bashkëshortet pa shokun e jetës, Gjokën e Eduartin, mbetën dy jetim pa babën e tyre, mbetën vëllezër e motra pa vëlla, të afërm pa njerëzit e tyre, shoqëria pa shokët e tyre, njerëzimi mangët me dy perona, pa dy prindër. Dhe Pse?

Në një shkrim, me titull "U vra një njeri", kam bërë apel, që njeriu të ruhet nga *pasioni dhe ti thërrasë arsyes*.

Vetëm arsyeja është ajo që të jep mundësinë për tu larguar nga e keqja.

Vetëm ajo i hap rrugën e mirësisë.

Vetëm ajo të ndriçon jetën për të jetuar në harmoni, në dashuri reciproke.

Nuk mund të ngjasë një marrëzi pa ndikuar mbi secilin nga ne. Të gjithë ne ndikohemi nga njeri-tjetri. Secili nga ne, ka brenda vetës "engjëllin" dhe "djallin", por lumë ai njeri që ka brenda vetës më shumë "engjëj", më me shumë mirësi, më me shumë forcë arsyeje.

Kur në vetvete mbizotëron "djalli", ligësia, zilia, ndodh dhe kështu ... Më falni t'u rrëfejë thelbin e dy ngjarjeve:

Së pari: Shumë kohë më parë, në gjysmën e shekullit të kaluar, ndodh një grindje në mes dy djem tezesh! Njeri mendon të pajtohen dhe për ketë le "pengun". Por ndodh "çudia"! E ëma nuk pranon, duke i thënë të birit: "Ti s'je djali i im, të mohoj rriten që të kam bërë, gjirin që të kam dhënë, në qoftë se "nënshtrhesh!" ..."

Djali tërheq "pengun!"

Pas disa kohësh, djali i dytë, vret të parin me gjithë bashkëshorte ...

Ja çfarë ndodh, kur një femër vetëm di të pjellë, por jo të bëhet nënë ... !

Së dyti: Në dimrin e vitit 1998, një djalë godet me grusht një moshatar të tij, për ... I godituri, shkon në shtëpi dhe i thotë babës, se çfarë i ka ndodhur Baba, i thotë: Mos rri në shtëpi, dil dhe ktheu kur të vendosësh "nderin" që të kanë marrë ...!

Ai del, personin e gjënë dhe e gjuan tetë herë me pistoletë. Vetëm një plumb e merr duke e plagosur lehtë, shtatë të tjerë plumba i shpojnë rrobat e trupit.

Ja çfarë ndodh, kur një mashkull bëhet me fëmijë, por jo të bëhet babë ... !

I theksova këto dy ngjarje, për të nxjerrë një përfundim, për të argumentuar atë që çdo marrëzi nuk mund të ngjasë pa ndikuar mbi secilin nga ne. Pra, mbi mua, mbi ty, mbi atë, mbi ato, mbi të gjithë!

Tragedia e parë ka ndodhur shumë vite më parë. Tragedia e dytë ka ndodhur në mesin e viteve 90-të. Tragjedi të tjera kanë ndodhur pas tyre, siç ndodhi kjo, me vrasjen Babe e Bir, Gjokë e Eduart Gurrën.

Kur u shpik arma e shfarosjes në masë, thuhej dhe thuhet se mjafton një neutron i vetëm për të filluar një reaksion zinxhir, që në një çast të vdesin mbi një milion jetë njerëzish. Është e vërtetë, po aq sa është e vërtetë se këtë neutron të vetëm e vë në lëvizje një "neutron" i trurit të njeriut.

Pavarësisht nga kompleksi i mjetit, është njeriu, ai, që eliminon jetë njerëzish.



Prandaj thuhet në gjuhën popullore: **"truri është sa një kokërr gruri dhe ku të qëndroj më parë i shkreti!"** Prandaj varet, se ku ajo kokërr "gruri" të ndodhet në vendin e caktuar, në kohën e caktuar dhe për qellim e caktuar?!

Kur një njeriu vret një tigër, thuhet se është sport, pra gjoja është sport, kur një tigër shqyen një njeri, thuhet çfarë mizorie, çfarë tragjedie, dhe ashtu është për vdekjen e një njeriu nga një kafshë e egër mishngrënëse.

Po, kur njeriu vret njeriun, madje dy njerëz, në mes të ditës, me breshëri automatiku, në makinën e tyre, duke shkuar për të ndalua pasojat e mëtejshme të djegies së shtëpisë, sikur gjuan në një gjah të lidhur, çfarë të thuhet?!

Cili është kafsha e egër mishngrënëse, ai që vuri "mjetin" në punë për të shpuar trupin e njeriut dhe nxjerrjen e gjakut të tij, apo ai, ata, që ecte në punën e tij, në punën e tyre, i cili mund të mos jetë larg shumë në mendësi me të parin?!

Tigri, e kap, e shqyen, jo se ka urrejtje në te, me njeriun, por se në mënyrë instiktive i turret, e rrëzon dhe e shqyen për t'u ushqyer. Ai, tigër nuk do ta dijë se çfarë është, është njeri me përgjegjësi familjare, apo një kafshë si të tjerat!

Po, ky njeri (ai që vuri në përdorim mjetin, armen) e dinë se nuk vranë thjeshtë një njeri apo dy, nuk e çova në atë "botë" një njeri apo dy, por dinë se ky njeri do të leri jetim dy fëmijë, do të lerë bashkëshorten, nënën e babën, vëllezër

e motra, e të tjerë, e të tjerë, që ia kanë nevojën e tij, nevojën e tyre, i kanë nevojën për dashurinë, nevojën për të ndikuar në jetesën e tyre nëpërmjet punës, nevojën që prindërit të "përcjellën" me dorën e tij, që shoqëria, të afërmit t'i kenë pranë në gëzime dhe në hidhërimë. Pra, ky njeri i bën me bindje që t'i arrijë të gjitha këto.

Jo njeri!

Kjo mendësi është mendësi i njeriut primitiv, është mendësi i një shoqërie primitive, se çdo zgjidhje tjetër do të ishte më e pranueshme dhe më me pak pasoja për jetën e njeriut, për te dy palët.

Duke shkuar për ngushëllim, një per-

ecën në dy këmbë, të bëhem edhe unë i tillë?

JO! Kurrsesi JO!

Nuk është e drejtë të luftojmë, të hakmerremi ndaj pasojës, ndaj mëkatarit se, pasoja është rrjedhojë e një shkakut se, mëkatarit është rrjedhojë e mëkatit. Që ne të mos kthehemi në njerëz të "egër", duhet çdo ngjarje, çdo fenomen t'ia japin arsyes.

Njeriu ka arsye, kafsha nuk ka arsye.

Njeriu me arsye nuk mund të kthehet në "kanibal", por gjen rrugë për të evituar të keqen, për të evituar derdhjen e gjakut të njeriut, me të cilin nuk zgjidh asgjë.

O njeri, qindra rrugë më të arsyeshme, më njerëzore, do të ishin gjetur për të zgjidhur problemin, se sa duke vrarë Gjokë Gurrën me djalin Eduartin!

O njeri! Nuk duhet të ecim me mesazhin e së kaluarës që sjellin trishtime, tragjedi e pasiguri. Me të kaluarën të mburremi për vlerat historike, kulturore, solidaritetin në mbrojtje të lirisë, me vlerat shpirtërore, siç është besa, mikpritja, e të tjera virtyte njerëzore, por e keqja në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojmë, që të na kushtëzojnë të ardhmen.

E ardhmja nuk është vetëgjyqësi, por ligj.

Në botë ka dy grupe njerëzish: Ata që kanë mend, të cilët janë shumica dërmuese, dhe ata që nuk kanë mend e që janë pakica.

Ata që kanë mend nuk udhëhiqen nga instinkti, por nga arsyeja e për rrjedhojë ecin drejt së mirës, drejt progresit, drejt rrugës së Zotit.

Ata që nuk kanë mend, udhëhiqen më shumë nga instinkti i agresivitetit, për rrjedhojë nuk veprojnë me arsye dhe është e vështirë të ecin pa konflikte, duke ia bërë vetës rrugën e jetës të vështirë e të pasigurte.

"Para së gjithash është më e lehtë të evitosh të keqen se sa ta trajtosh. Një herë po e lejoje, e keqja ulet këmbëkryq e bëhet Zot i shpirtit tënd, bëhet më e fortë nga ç'je ti i aftë për ta shmangur, ajo nuk lejon ta ngasësh dhe as ta zvogëlosh", theksonte SENECA.

Me qindra njerëz, burra e gra, të rij e të reja, shkuan këto ditë tek familja e Gjokë Gurrës, për ti dhënë forcë, për të bërë përpjekje për ta lehtësuar sa do pak dhimbjen e tyre.

Vëllezërit e djali i dytë i Gjokës, të afërmit e tyre, të fortë, japin duhan, mbajnë qëndrim serioz, duke i thënë secilit fjalët tradicionale: *Ju paftë Zoti me të mira! Paçi faqen e bardhë! Mos u shpenzoni burra!*

Djali i dytë i Gjokës, i ri, por i pjekur me mendësinë për të qëndruar i fortë para kësaj tragjedie, është i fortë, jep duhan, pyet, jep bisede ...

Sa keq, që kjo njomishte të marri ngarkesë të peshës së rëndë para kohe, peshën e mashkullit të familjes. Peshë është e rëndë dhe rrezikon me e përkul para kohe!

Këta qindra njerëz, nga e gjithë fshati

Festa e Alpeve -2023

Sot me datën 9 korrik 2023, dite e Di-ele, në Theth u zhvillua “Festa e Alpeve” 2023

Një veprimtari festiv e organizuar nga Bashkia Shkodër, Administrata e Zonave të Mbrojtura, me objektiv promovimin e vlerave kulturore, turistike e artistike në zonën e Dukagjinit.

Si gjithmonë Shoqata Atdhetare “Dukagjini” një zë i fuqishëm për vendlindjen!

Një organizim i suksesshëm nga drejtuesja organizative zj Aurora Piroviq dhe grupi i saj.

Pjesëmarrje nga Peja, Gucia, Malësia e Madhe, Tropoja dhe Tirana,

Në këtë veprimtari veçohet anëtarja e kryesisë së shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, zonjusha Klodjana Serraj për modernimin e zhvillimit të veprimtarisë me shumë kompetencë e thjeshtësi.

Gjithashtu veçohet N/kryetari i Shoqatës, Agron Hasanaj, për përsëritjen e rastit në emër të saj. Respekt për gjithë pjesëmarrësit artiste, këngëtar, valltare, artizane (në veçanti File Strugaçi) dhe miq të folklorit; pjesëmarrësit e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, kryetari z Ndue Sanaj, z Gjergj Leqejza (Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër), Kole Çardaku, Gjon Shtegu, Prele Shytani, Kole Hasani, grupi “Besa-Shoshi” e të tjerë.

Veçanti ishte prezantimi në publik me një fjalë përsëritje nga N/kryetari i sapo zgjedhur i Bashkisë Shkodër z Rudin Beka, që vizionin dhe përkushtimin për turizmin e ka pjesë të specializimit të tij

Kronika e kësaj feste është shumë e gjatë dhe duhet plotësuar me qetësi, por perceptimin e parë le ta krijoni me disa foto..

Lulash Brigja



Thethi gjerdan mbi gjoksin e Alpeve

Për Thethin dhe thethjanët, është shkruar që në vitin 1688 nga Koronëlli, pastaj nga Nopca, Durham, Lanë, Baldaci, Hofman, Bejker, e të tjerë deri te albano-logu Robert Elsie, trupi i të cilit sipas amanetit të tij prehet në varrezat e fshatit Theth.

Duke u rrethuar nga malet e larta mbi 2000 metër, me qafa e gryka mbi 1600 metër, që lidhet me zonat e tjera, me Kelmendi, Vuthajt, Valbonen, Bogen e Curraj Epër. Ka një sipërfaqe afër 300 hektarë, nga të cilat 160 hektarë janë pyje dhe pjesa tjetër sipërfaqe shkëmbore.

Thethi ka 80 burime uji, 170 shpella të mëdha e të vogla, me një flore të pasur dhe të larmishme. Në Theth rriten 1500 lloje bimësh, që përfaqësojnë 50% të florës të vendit tonë dhe 14% të asaj evropiane.

Ka mbi 70 lloje bimësh mjekësore, shumë prej tyre të rralla dhe në rrezik për tu zhdukur. Me një faunë të pasur dhe të veçantë, me rreth 20 lloje gjitarësh, 50 lloje shpendësh, 10 lloje zvarranikesh e të tjerë.

Zona e banuar e Thethit, shtrihet nga 600 deri në 1000 metër mbi nivelin e detit, qendra e tij, te kisha është 740 metër. Kalon lumi mes përmes fshatit duke krijuar një Budapest të vogël, por ky lumë ndryshon nga Danubi se, tani po shfrytëzohet vetëm në Theth ku ka buri-min dhe te lumi i Shalës, ku derdhet.

Mes kësaj bukurie të natyrës, kanë jetuar dhe jetojnë prej shekujsh thethjanët. Kanë shfrytëzuar mundësitë që ju ka dhanë natyra, duke bashkëpunuar, kuptuar dhe jetuar, në harmoni të përhershme me njeri tjetrin. Ata i dhanë jetë dhe vlerë kësaj luginë, duke bërë që ky fshat të njihet jo vetëm për bukuri, por dhe për kulturë, tradita, bujari, inteligjencë e të tjera. Thethjanët u dalluan për bujq dhe blegtorë të zotët, mjeshtër të gurit dhe të drurit, përpunues të veçantë të nënprodukteve të qumështit, mishit e leshit. Ishin e janë rapsodë, këngëtarë, krijues dhe interpretues të folklorit, me histori, etnografi e topografi të veçante dhe unikale, jo vetëm në shkallë zone, por dhe në shkallë vendi.

Këto vlera u panë dhe u vlerësuan nga të tjerët, si fshat i veçantë për zhvillimin e turizmit, që në fillim të viteve 30 të shekullit të kaluar. Thethi është vizituar në mënyrë të organizuar nga dashamirë të shumtë të këtij fshati nga qyteti i Shkodrës. Thethin filluan ta frekuentojnë, ta vlerësojnë, e të investojnë pushtetet lokale dhe qendrore gjatë gjithë kohërave. Kështu u lidh me rrugë automobilistike me Shkodrën në vitin 1935. Në vitin 1936 hapet shkolla e pare shtetërore me mësues Karlo Larja dhe që ka vazhduar deri në ditët e sotme. At Shtjefën Gjeçovi hapi shkollën e parë në Theth në vitin 1917, por nuk pati vijueshmëri. Në vitin 1965 ndërtohet shtëpi pushimi për punëtorët. Në vitin 1937, është ngritur në Theth një ndërtesë shtetërore për sportet malore dhe me 18 korrik të vitit 1956 zhvillohet veprimtaria e parë zyrtare e alpinizmit shqiptare në Theth.

Thethi shpallet Park Kombëtar në vitin 1966. Janë shpallur me vendim qeverie 11 monumentet e natyrës dhe 6 monumente

Gjithë këto vlerësime dhe arritje, kishin bazë punën, sakrificat dhe përpjekjet e thethjanëve, për të rritur zërin dhe tra-

është zë dhe figure, realitet dhe identitet, për vetën edhe shtetin.

Thethi ka çdo ditë festë. Thethjanët dinë të festojnë dhe tu krijojnë mundësi të tjerëve për të festuar. Tani dihet nga të gjithë, si funksionojnë projektet shtetërore apo private dhe mundësitë për ti zbatuar në mjedise sa me të përshtatshme, të cilat i gjejnë vetëm në Theth.

Veprimtaritë e zhvilluara këto vitet e fundit, në kuadrin e hapjes të sezonit turistik në Theth të emëruara sipas mendimeve të çastit, nuk i bënë thethjanët të ndihen të shqetësuar, por urojmë të kemi sa më shumë miq, shokë, dashamirë dhe turistë që na vizitojnë. Mirë se të vinë kurdo që të vinë!

Që të kemi një festë si fshat, në shërbim të turizmit ka mbetur për dy gisht letër për të marrë formë zyrtare, e cila ishte detyrë e pushtetit lokal.

Fshati Theth ka pasur Ditën e Beshkës, të dielën e dytë të qershorit, që ishte afati për të kullotur bjeshkët alpine. Kjo festë do të ishte mirë të zyrtarizohej dhe të ishte "Dita e bjeshkës e Thethit".

Megjithatë Thethi i afron të gjithëve të festojnë, të gëzojnë, të pushojnë e të argëtohen në çdo stinë. Kështu rriten vlerat, të ardhurat dhe përgjegjësitë për të pritur e përcjellë miq e dashamirë të shumtë të këtij fshati.

Zef BARI, Korrik 2023



të kulturës, ndër to muzeu etnografik për Dukagjinin në shtëpinë e Lulash Boshit.

Ky fshat ka trashëguar dhe është dalluar për nisma, iniciativa, që bëheshin shembull për ndryshim, përparim e zhvillim. Vlen të veçohet, që gati po harrohet, nisma e kolektivit mësues e nxënës të shkollës tetëvjeçare Theth në vitin 1967 me moton: 'Ta bëjmë fshatin të bardhe si bora e bjeshkëve, të rritim fëmijët si çetina'. Kjo nisme pati jehonë në të gjithë vendin dhe përfundoi me një veprimtari në shkallë kombëtare në Theth.

ditën e këtij fshati.

Prandaj gëzoheshin njerëzit të kishin një mik në Theth, shok, kumbarë apo probatin. Faktet tregojnë, që Thethi po konkurren bindshëm në shkallë vendi në turizmin malor. Në një natë në këtë fshat akomodohen 2000 persona edhe pse ligji 7501, ka sjell shume probleme, bashkë me ca segmente të shtetit, që kane për detyrë ti zgjidhin këto probleme.

Në Theth tani fliten të gjitha gjuhët kryesore të botës. Është doganë, është aeroport, është port e ambasade. Thethi



Përkujtohet 108 vjetori i tribunit të lirisë Mehmet Shpendi (Nderi i Kombit)

108 vite më parë historia fliste ndryshe. Ballkani ziente nga lufta, Dukagjini mbronte me gjak pragun e shtëpisë, trimat e trimëreshat flijoheshin për liri.

Në ato dite të përgjakura të korrikut 1915, Plani dhe Gjurajt i dhuruan lirisë 72 dëshmor të pafajshëm, Shala flijoj tre nga prijësit e saj legjendar me në krye t'parin e Djelmnis Mehmet Shpendi dhe në gjithë Dukagjinin u flijuan 106 dëshmorë.

Në këtë përvjetorin qëndrese dhe lavdie, sot Shoqata Atdhetare "Dukagjini" vendosi kurora dhe organizoj një veprimtari përkujtimore pranë trupores së Mehmet (Sokol) Shpendit.

Reportazhin e kësaj veprimtarie më shumë e përcjellim me foto, por për kujtesë dhe ne respekt të këtij emri të madh, po paraqesim pak histori.

Truporja e Mehmet Shpendi është një skulpturë e derdhur në Bronc, realizuar nga Skënder Kraja, e vendosur në një lulishte publike afër Ish-Fermentimi i Duhanit, në Shkodër, ajo shikon nga malet dhe duket sikur thonë - Atje lind dielli!

Mehmet Shpendi erdhi i derdhur në bronz, falë iniciativës të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe zemrës bujare të banorëve të kësaj bashkësie.

Inaugurimi i monumentit të Mehmet Shpendit është bere me 16 korrik 2015, në kuadrin e 100 vjetorit të rënies së tij dhe të Martin Camajt është bëre me 15 tetor 2015. Tete vite më parë u ngrit shtatorja e Mehmet Shpendit në qytetin e Shkodrës. Është kontribut i shumë njerëzve që banojnë në Shqipëri dhe në shumë vende të botës, që nga Miçigani, Nju-Jorku, Belgjika, Italia, Anglia, Greqia, Tirana, Shkodra.

Sa shpejt kaluan vitet dhe shtatorja e Mehmet Shpendit na vështron nga piedestali i historisë! Janë rritur pemët dekorative, është shtuar gjelbërimi, por më kryesorja është se është rritur akoma më shumë imazhi i Mehmet Shpendit.

Kjo shtatorja ju flet përditë bijve dhe bijave dukagjinase, u jep porosi e këshilla, me veprën e tij të pavdekshme.

Shtatorja e Mehmet Shpendit, që nga dita kur u vendos në atë pedestal, është një simbol krenarie, një dëshmi historie, është një gur themeli midis të shkuarës dhe te ardhmes.

Mehmet Shpendi, rrjedh nga fisi kryengritës i Shalës, i lindur në fshatin Pecaj, në vitin 1851, aty ku fjala, puna e pushka ishin bashkëlidhur në mënyrë të pazgjidhshme, aty ka ndahet kuvendi, aty ku merr rrugë besa, burrnia e urtia, aty ku ka prijës të përzgjedhur, të fortë për pushkë e të urtë për fjalë.

Mehmet Shpendi, me mendjen dhe punën e tij fitoi respektin në të gjithë zonën e Dukagjinit. Burri heroik i Shalës, u shqua në shumë luftëra për trimëri dhe qëndresë të vendosur Kombëtare, duke mos pushuar së luftuari për liri dhe Atdhe deri se plumbat e tradhtisë e përshkuan duarlidhur dhe në besë, në Ndërkisa të Planit, me 15 korrik 1915.

Edhe në momentet e fundit i dërgoi lajmin Shalës që të mos dorëzohej duke luftuar gishtin e pushkës për nën gju, e duke lënë fjalët lapidar

"Tokë e qiell paça lanë dorëzane, kurrë anmikut besë mos me i zanë!"

Mehmet Shpendi është figurë unike historike e krahinës së Dukagjinit e

papërlyer gjatë gjithë jetës së tij. Koha dhe iniciativa e Shoqatës Atdhetare Dukagjini beri që të vendoset në vendin e merituar që ka sot.

Mehmet Shpendi jetoj 64 vjet, prej të cilave 42 vjet është me pushkë në dorë, e përfaqe, në shërbim të vendit të tij, çështjes shqiptare, për liri e pavarësi. Ai është përfaqësues tipik i vegjëlisë, pa privilegje personale dhe familjare, arriti të bëhet simbol për brezat në ndërgjegjen atdhetare, si prijës i Djelmnisë së Shalës e Dukagjinit, si drejtues i betejave të stuhishme, si dijetar i kuvendit, si pleqnues i drejtë sipas të Drejtës tradicionale të kohës e si zbatues i saj, si një atdhetar me ndërgjegje të lartë kombëtare, i cili u flijua për idealin më të shtrenjtë, atë të atdheut.

"Djelmnia e Shalës", nën drejtimin e Mehmet Shpendit, është unike për organizimin politiko-shoqëror-ushtarak të kohës. Ajo qëndroi stoike dhe e pazhigatur. Djelmnia u ndje si një forcë qeverisëse-ekzekutive në territorin e saj. Kjo nxiti që edhe krahina të tjera ta ndiqnin, të organizoheshin dhe të bashkëpunonin me të.

Duke gjykuar nga mendimet, të rejtat që solli në jetën e krahinës, Djelmnia e Shalës, veprimet dhe shikimin pozitiv drejt së ardhmes, pse jo edhe nga moshë, mund të thuhet pa druajtje se ajo qe formacioni i parë rinor shqiptar me këtë nivel organizimi, me këtë largësi shikimi, me këtë thellësi mendimi. Franc Nopça e ka quajtur "Opozita e parë shqiptare!"

"Mehmet Shpendi ka qenë dhe mbetet simboli i qëndresës popullore të Dukagjinit në udhëkryqet më delikate të historisë sonë nacionale", shkruante Ndue Sanaj ato ditë që u vendos shtatorja.

Sa herë që kalojnë aty brezat e rinj dhe të vjetër të Dukagjinit, e shohin krenar këtë shtatore dhe nga shpirti ju del një thirrje.

« Mirë se erdhe o vëlla ! Mirë se erdhe në Shkodrën tonë Iliriane, së cilës ju bëre mburojë në kohët më vështira!"

Dukagjini kështjelle e pamposhtur e luftës për liri, gjithmonë ka pasur dhe ka për të pasur lindje e rritje të figurave që i shërbejnë krahinës dhe vendit me mend e me zemër.

Lavdi Mehmet Shpendit dhe të gjithë atyre që derdhën gjakun për Lirinë dhe mbrojtjen e trojeve tona, Atdheut, që na e lanë amanet të parët.

Me këtë rast Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini: ndau edhe disa tituj nderi:

Me titullin "Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini":

- 1-Prof. Dr. Vuksan Kol
- 2-Profesor Dr. Lekë Sokoli
- 3- Gazetarin Zef Nika

Me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini":

- 1- Major Lekë Vojvoda
- 2-Filip Summa-Çekaj
- 3-Tef Pogu
- 4-Gjekë Gega i krahinës së Shllakut



Festa e shenjte në majën e Cukalit

Me datën 29 qershor 2023 është kremtuar mesha e shenjtë në majën e Cukalit, në Shllak nga famullitari i Shllakut Dom Marjan Gjinesha, te rrënojat e Kishës shekullore të Shën Palit dhe Shën Pjetrit, me rastin e festës së Shën Palit dhe të Shën Pjetrit, që mban emrin edhe vetë Kisha, e cila ndodhet në majën e Cukalit.

Kjo festë, është festuar çdo vit në bjeshkën e Cukalit nga shumë banorë të Shllakut dhe ka një traditë qindra vjeçare.

Mbas meshës së shenjtë vijon lëvizja e të pranishmeve në meshe, për tek Fusha e Liqenit, pak minuta larg ku ndodhet

Kisha, që secili në mënyrë individuale e familjare apo grupe shokësh hëngrën drekën, duke shijuar ushqimet që kishin marre secili me vete në ajrin e pastër dhe bukuritë që të ofron fusha e liqenit dhe malet që e rrethojnë.

Me këtë rast, në fushën e liqenit u zhvilluan lojëra të ndryshme popullore, volejball, futboll e të tjera. Gjithashtu nuk mungoj as muzika nga këngëtarët e krahinës, që ishin të pranishëm dhe interpretuan direkt, nder ta këngëtarit i njohur nga Dushmani Mark Vata dhe Ndoc Shporaj nga Mazrreku. **Përgatiti Mark Gjeka**



KËSHTU NGELEM VLLAZËN

Rrëfimi i atdhetarit, patriotit e luftëtarit Arif Ahmet Hajdarmataj

Gjermania gjatë luftës Dytë Botërore, në gjithë Shqipëri, bëri dëme të mëdha, duke djegur shtëpi e hedhur në erë ura, duke vlarë njerëz të pafajshëm burra, gra e fëmijë.

Sipas kujtimeve të atdhetarit, patriotit e luftëtarit Arif Ahmet Hajdarmataj nga fshati Zogaj – Tropojë, i cili ishte shok arme me Heroin e Popullit Bajram Curri, që për veprimtarinë e tij atdhetare, luftëtar besnik i Bajram Currit, Arifi dënohet me 101 vjet burg nga regjimi famëkeq i Ahmet Zogut dhe kushërinë e tij Hoxhë Zog Hajdarmataj varet me litar në qytetin e Krumës të Hasit, po nga regjimi i Zogut (Sot gjimnazi i Zogaj mban emrin e dëshmorit Hoxhë Zog Hajdarmataj).

Arifi kujton: “Tre Gjermanë, të shoqëruar nga një gjakovar i cili luante rolin e përkthyesit dhe të shoqëruesit, meqenëse e njihje shumë mirë fshatin Zogaj të Malësisë së Gjakovës, që një kodër e ulët e ndajnë Gjakovën me Zogajt”. Ata zbresin në qendër të fshatit Zogaj dhe fillimisht vranë patriotët të tre vëllezërit Rexhë Mehmet Hajdarmataj, Kadriinë e Muslinë si edhe nusen Rushë Hajdarmataj, ja venë flakën shtëpisë së tyre dhe këta 4 trupa i hedhën në flakën e zjarrit, që ishte marrë shtëpia. Tragjedi e vërtetë, ku do kalojnë shumë breza dhe kjo në memorien e tyre do të ngelin përgjithmonë për vdekjen e këtyre 4 dëshmorëve të atdheut, të cilët

dhanë jetën në mënyrën më të pa imagjinuar, që ne sot të jemi të lirë e të lumtur.

Të 3 gjermanët me shoqëruesin drejtohen për tek shtëpia ime. Një komshi spiun (Hafije) kishte raportuar tek gjermanët se komandanti i batalionit partizan të Hasit, Ismail Poga me 3 partizanë ndodhen tek shtëpia ime. Në të vërtetë Ismail Poga me disa partizanë të Hasit dhe të çetës partizane të Zogaj kishte marrë disa aksione luftarake kundër gjermanëve dhe postave ushtarake të tyre si në Zogaj, Bytyç, Kam e Qafë Prush. Ardhja e Ismail Pogës me partizanët e Hasit, kishte për qëllim koordinimin e aksioneve luftarake të hapësirës Zogaj të udhëhequr nga komandanti i kësaj çete partizani Isuf Musë Hajdarmataj me çetën e Bytyçit të udhëhequr nga 3 vëllezërit Shaban Haxhi Demaliaj, Hasan e Bajram Demaliaj. Pasi e pritëm për zemërsisht Ismailin me shokë, filluan bisedimet për takimet e ardhshme e aksionet me drejtuesit e çetës partizane të Zherkës, Rexhep Arif Hajdarmataj dhe Shaban Sadik Hajdarmataj me partizanët e qendrës Zogaj, Bistim Hoxhë Hajdarmataj, Bali Arif Hajdarmataj, Maxhun Shaban Hajdarmataj, Ukë Shaban Hajdarmataj dhe Ukë Arif Hajdarmataj si dhe në lagjet Xhuxh, Mahallë e Epërm, Xhediaj me partizanët Hysen Kadri Aliaj me Matosh Matosh Mertinaj, Muhamet Ozman Xhediaj e Niman Musë Hajdarmataj dhe detyrat që do të kenë secili në të ardhmen.

Me Ismailin kishim thithë gjakun, ishim ba probatima, domethënë ba vllazën, prandaj më besonte për çdo gja dhe detyra që më linte ua transportoja menjëherë partizanëve

... Një thirrje e fortë
O Arif Ahmeti!

Menjëherë dola në krevet të shkallëve (ballkon) të kullës sime 3 katesh dhe ju



*Ismail Poga,
Komandant i Batalionit Partizan të Hasit*

drejtova: Mirëserdhët!

Zbrit, zbrit poshtë, foli duke ma ba me dorë Gjakovari i shoqëruam me 3 gjermanë.

Arif! Na kena besim te ti, si burrë i pjekun e me sedër, me na tregue, a ke mrena Ismail Pogën me shokë? Në ato momente 2 gjermanë me automatikë në duar, zunë pozicion në 2 kungët e kullës, ndërsa gjermani i 3 ndenji me shoqëruesin. Po more, po ju tregoj të vërtetën pa dorashka, pa rrena, Ismail Poga me 3 partizanë ka ardh në shtëpinë teme para 1 satori (Siç e mësova ma vonë nga Ismaili, të 3 partizanët e Hasit me Ismailin kishin hi-

pur në pullaz të shtëpisë dhe po ndjeknin zhvillimet e ngjarjes, 3 partizanët e Hasit do të asgjësonin 3 gjermanët, ndërsa Ismaili do ta vrasin në fillim Arifin si njeri besë premë, tradhtar, ndërsa shoqëruesi mundësisht të kapet i gjallë se duhet për informata.... Ismailit i kujtohen fjalët e mençura të babait të tij që thoshte: “Biro kurrë mos u ngut as në luftë as në kuvend apo në gëzime”.

Punë sekondash e Arifi do të shtrihej përdhe nga Ismaili.

Fol bre Arif, na i nxjerr jashtë ata komuniste, të pa fe, flet me za të naltë gjakovari.

Po bre, por Ismaili me shokë mu dukën se ishin të unshëm (të pa ngrënë) dhe më lypën bukë. Unë ju dhashë një bukë me një pshere djathi të mshtjellun në façoletë (shami), të cilët u nisën menjëherë për në fshatin Zherkë ku thanë se kishin një plan për të hedhur në erë postën gjermane në Zherkë.

Sapo përkthyesi ua përktheu gjermanit, ata si vetima u larguan duke marrë drejtimin e fshatit Zherkë ku ndodhej një orë rrugë larg shtëpisë sime.

..... Pastaj Ismaili me shokë u përfaqua me mua, i cili ishte ba ujë në djersë nga tensioni që kishte kaluar.

Kështu ngelëm përjetësisht vllazën të besës.”

..... Vitet kalojnë, ku brezat përcjellin traditat

Ibrahim Hajdarmataj, Anëtar i Komitetit Kombëtar të Organizatës të Veteranëve dhe Pasardhësve LANÇ “Nderi i Kombit”

Me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”:

- 1- Lazer Kulla
- 2-Petrit Sokoli
- 3-Marjana Koçeku,
- 4-Motër Dukate Radoja
- 5-Kol Kodra

Kontriboj financiarisht për përgatitjen e zhvillimin e kësaj ceremonie, Pal Lera, me banim në Nju-Jork, të cilin e falënderojmë me shprehjen popullore: Pal Lera paçi e dhënçil!

**Lulash Brigja e Klodjana Serraj,
16 korrik 2023**



KUSH NA E NXJERR GJUMIN QË T'I HAPIM SYTE?

NE 63 VJETORIN E LINDJES DOKTOR VAT MARASHIT

Është rasti dhe dëshira të shkruaj diçka për një doktor, mjek, hero të heshtur. Punon dhe jeton larg vendlindjes dhe atdheut, por pa i harruar ato dhe bashkëkombësit e tij shqiptar. Mirë por më duhet të përzgjedh materialin, sepse është kreshnik malësie. E për ata rapsodi popullor thur vargje epike zjarrmi heroizmi dhe zulme eposesh legjendare. Mjerisht unë nuk di t'i thur ato vargje obeliskë heroizmi e kreshnikësh. E sot këto lindin, rriten, shkollohen në Gimaj të Shalës së Dukagjinit, por punojnë me vetëmohim, derdhin pasionin e mjekut, të fermerit, të udhëheqësit në një vend të huaj. Këtu në Fiezole (Itali), vendbanim i hershëm etruskësh, pranë qytetit të kulturës e artit, Firences në krahinën e Toskanës në Italinë qendrore. Megjithatë po përpiqem që për doktor Vat Marashin të "shkarravis" disa mendime, të sjell disa mbresa të jetuar kur për disa ditë isha pacient i tij, sa të mundem në këtë ditë të lindjes tij.

Sytë m'i mbushi me lot!

Heshtje spitalore. Klimë qetësie të sëmurësh. Muzgu sa kishte mbështjellë me vellon e errësirës ndërtesat e shumta të spitaleve të Karezhit, brinjat me gjelbërime, vila e mjedise spitalore, këtu në një kënd të qytetit të Firences.


Isha mbështetur në kapakun e derës së dhomës ku isha i shtruar. Ajo shikonte nga korridori i ndritshëm dhe i gjatë, në katin e dytë të Vilës "Ulivela". Ashtu i mbështetur shikoja andej këndeje për të kaluar kohën e nga dëshira për të ndenjtur pak në kam. Kusht i të mbijetuarit. Sigurisht mendja me ikte larg në kohë e hapësirë. Ndërkaq nga hyrja e korridorit ku ngjiten shkallët dhe ndodhet kabina e ashensorit, vështrova një njeri veshur me rroba të gjelbërta, ngjyrë e cila më pëlqen shumë. Ai afrohesha pa u ndalur. Ndërkohë mendje kërkonte në qelizat e kujtesës për t'a njohur. Në çdo hap afrimi, po vizatohesh në kujtesë një njeri i njohur. E këtu ndalesh përfytyrimi. Dysihimi më përvëlonte. Vendosmëria dridhesh si gjethet e mëshhtëknës nga flladi i mbrëmjes.

Trup mesatar. Koka rrumbullake, mbi të cilën ndodheshin flokë të rralla ngjyrë gështenjë. Sytë i shkëlqenin nën vetulla të gjana. Nuk u besoja syve. Shtrëngoja fort instinktivisht dorezën e derës duke u mbështetur më shumë mbi atë sikur për t'i kërkuar ndihmë.

Ai sa më shumë më afrohesha, kujtesa me bëhesh "më e pëlleshme". Një buzëqeshje plote ëmbëlsi, ndriçoi e zbukuroi fytyrën e tij të qetë e dashamirëse. Natyrshëm, me lot ndër sy, i tradhtuar nga emocionet e forta, e thirra: Eh doktor Vat Marashi, e këtu përse na keni ardhur? - ndërkaq sytë ia kisha ngulur fort plotë mall e dashuri të ngrohtë njerëzore (e dija se shërbente në spital tjetër).

Edhe pse gojën të mbuluar me maskën e bardhë detyruar nga një botë pushtuar nga virusi COVID. U përqaftua fort. U pyetëm sipas zakonit e edukatës shqiptare. Ai me foli qetësisht, me buzëqeshjen e amel çelur mbi fytyrë e buzë: Unë kam mbi një vit që punoi në këtë spital. Sonte kam turnin e natës më tha dr. Vata.

Shikoja këtë malësor (vite më parë i kisha be një vizitë në vilën e tij në mes ullinjve e selive) midis këtyre kolonave të



Mehil Marashi (i ati) dhe Dr. Vat Marashi

gjelbërta kryeneçe e shtatore mrekullie. Dhe vazhdova: Po si më gjete këtu, rastësia apo informacion i marrun nga një burim. Edhe pse i sëmurë rëndë ndjeva shumë gëzim që takova mikun tim dr. Vatën. Ai vite me parë më kishte përshkruar veprimtarinë e tij në Shqipëri dhe Itali. Në vitet 1985 deri më 1990, kishte shërbeu si mjek në spitalin e Iballës-Puke, më pas si drejtor; pastaj në kryeqytetin shqiptar, Tiranën nga 1990 deri 1994 ku edhe u specializua për Pediatri e Gjinekologji. Dr. Vat Marashi prej më se 20 vitesh punon mjek, kujdeset për të sëmurët në spitalet e Firences duke kryer më parë disa specializime në Universitetin e Mjekësisë në këtë qytet.

Lexova në FB një përshëndetje me rastin e ditëlindjes, (20.08.2022) ku në fund shkruanit adresën këtu. - Tha ai duke me hedhur vështrimin nga koka te këmbët me kostumin e spitalit shapkat e zeza dhe maskën e bardhë, ku zëri dukesh që vinte nga një pus i thellë.

Ai me shikonte në sy për të më zbuluar çfarë më kishte ndodhur. Natyrshëm kureshtja e një doktori tani ma me përvojë pothuajse katër dhjetë vjeçarësh. Ai vazhdoi: Eh, - thashë me vete kur mbarova leximin e kumtit, - Selmani paska ardhur ne trojet e mia. E kuptohet erdha të të shikoi e përshëndes. - Në fytyrën e tij kishte ardhur pranvera e lulëzueshme.

Nuk më mbeti gjë tjetër veçse t'i tregoja udhëtimin e sëmundjes time. Sapo mbarova ai më shtrëngoi dorën e djathtë, më ra pak sa shpatullave e më tha: Po shkoi të lexoi kartelën tuaj. Jam në shërbim dhe do të takohemi. - ndërkohë po ecte drejt fundit të korridorit. Sapo hyri në dhomën e doktorëve, unë tanimë nuk

e shikoja edhe pse kisha dëshirë të flisja pa u ndalur për veprimtaritë e tij të shumta. Për gjallërinë e patriotizmin e tij flakadane. Hyra në dhomë. U shtriva në krevatin bore të bardhë. Të sëmurët flinin qetësisht. Disa yje i shikoja në qiellin e kaltër nga dera e xhamte e ballkonit. Atë natë një gjumi i thelle më pushtoi.

Premtime të pafund dhe "vegjeli", që rrehet me pak.

Doktor Marashi tani ma, me të fol-

vistën shqiptari, Nr. 1. Bukuresht 2017. "Kohë e zorshme, probleme t' shumta, drita të rrejtshme verbuese para syve tanë, oferta zgjidhjesh nga të tria frontet: Modernët, të moderuarit dhe konservatorët, por me mjete të pa përshtatshme e mbi të gjitha: pa sinqeritet dhe në rrugë "pa krye,, pa njohje reale të gjendjes, mashtrime, premtime të pa fund dhe "vegjelia", që rritet me pak!, Analize e cila i vendos vulën e saj kohës ku jeton e vepron kombi shqiptar.

Sjelljet e dr. Vatës me kolegët, me shokë të çfarëdo niveli ai i koncepton, gjykon dhe vlerëson me plotë mençuri dituri, fituar nga përvoja e jetës, pasuria e tij bibliotekare e kultura e tij e gjerë dhe e thellë. Ja një shembull: Dr. Marashi shkruan më 28.06.2018 gjatë takimit me, "Doktor Lazim Destani - Honoris Causa, kësaj radhe shkëlqeu në sy nga gëzimi... Gëzim për të tjerët kur i sheh në rrugë të mbarë dhe të bashkuar. Mikpritja e tij sa e thjeshtë aq e përsosur; jo vetëm për nivelin, por kryesisht për zemrën, bash si i thonë "Buke" e kripë e Zemër., Dhe ja një mikpritje tjetër e përshkruar me ndjenjë miqësie e bujarie shqiptari: "Mbrëmë me 08.12.22 në Konakun e Bajram Aliut kishim nderin ta bëjmë një ndeje me miqtë (shokët): Vat Marashin



Dr. Vat Marashi

men në italisht thirr në skenë filozofinë e tij. Ai përdor gjuhën shëruese të mjekut. Por ai din tani ma të zbuloi sëmundjen e t'i gjej asaj ilaçin e shërimit. Me sjelljet e edukatën e tij ai bana për vete të sëmurët nga Maroku e Laosi, nga India e Kina, nga Turqia e Senegali, nga Bregu i Gjelbërt e Siria. Ndërsa dikur në rini, ai shëronte e mjekonte ju shërbente me pasion e plote dhembshuri të vegjëleve e të rriturve në fshatin Iballë në Pukë.

Dr. Marashi gëzon krenarinë e malësorisht, shkëlqen në gjykimet politike e zgjidhjet ekonomike, por edhe shkruan si me mendjen e një filozofi. Më ka mbetur në kujtesë një shkrim shkruar në "Re-

me djalin Bernardin nga Shkodra, jeton në Itali. Fitim Brahimi nga Mitrovica me djalin Edmondin që jeton në Gjermani edhe instrumentistin kosovar Morina prej Prizreni jeton në Kassel-Gjermani., Mikpritja e tij në vilën e tij me verën prodhuar nga rrushet e tij, vatra e tij bujare me nenën burrneshë malësie, me këngën e tij shoqëruar me çifteli natyrisht të duket vetja me qenë në zemrën e fshatit malor të Gimajve. Por Vata me komunikimin plotë ëmbëlsi, thjeshtësi, shoqëruar me biseda me përmbajtje të ndryshme, të shëmbëllen vetja brenda një enciklopedie e mjediseve malësore të Dukagjinit e Kosovës martire të cilën Dr. Vata e ka shumë për zemër. Ai e shpreh plotë freski e optimizëm në vargjet poetike: "Kosovë trimes pik mäs parit,/E gjithkrah asht fara e Shqiptarit,/Nëpër treva, troje t' veta,/E gjithkrah, ku i ka çue jeta,/Ma gzoftshin Vjetin e Ri! (31.12.2019),,

Për të kuptuar zgjuarsinë e tij, gjykimin e ftohtë e aftësinë parashikuese, po japim një frazë shumë kuptimplote për situatën Shqipëri Kosovë. Shkruar më 30.07.2021: "Ska randsi nga vjen rreziku, dami e tradhtija..., bile i yti asht ma i rrezikshëm se i hueji, se atij nuk i «ruhesh» prej tij nuk e pret. Por, prap te thanja e t'Përve po kthehem: «Asht ma e vështirë me mbajta kështjellën se me marrë» - kanë thanë t' Dijshmit!"

Nuk mundesh t'i përmbledhësh në një shkrim me rastin e



Lazim Destani (biznesmen i njohur) Dr. Vat Marashi

Ike fizikisht, por drita jote do të ndriçojë gjatë

Prof. dr. Vehbi Hoti-mishërim i humanistit e mendimtarit pedagogjik

Shtatori i viti 1971 ka qenë për mua një ndër momentet më të rëndësishme të jetës sime-fillimi i studimeve në Institutin e Lartë Pedagogjik-Shkodër (sot, Universiteti "Luigj Gurakuqi"), në një qytet me tradita të shkëlqyera, në arsim e kulturë, me personalitete të shquara në shkencë, në art, në sporte, në muzikë, në letërsi e të tjera. - me një traditë të pasur të shquar e prurje bashkëkohore cilësore, të hershme e të vona.

Ky institucion i rëndësishëm, i hapur në vitin 1957, u bë epiqendër e rëndësishme jo vetëm për Shkodrën, por për gjithë Veriun e Shqipërisë e më gjerë, që rrezatoi shumë në të gjitha fushat e jetës, që trashëgoi e pasuroi traditën 2500 vjeçare, duke i dhënë një shtysë të rëndësishme zhvillimeve bashkëkohore.

Unë isha i familjarizuar e dashuruar me këtë qendër të rëndësishme, pasi kisha mbaruar këtu shkollën e mesme për mësuesi. Përfitim e së drejtës për në shkollë të lartë, disi me vështirësi, e quaja një shans e fatbardhësi, që duhej shfrytëzuar pozitivisht, si një rast që përsëritet zakonisht një herë në jetë. Në auditorin kryesor të Institutit patëm bërë hartimin para 4 vitesh, në atë tempull që na dukej si hyjnorë e si një ëndërr e perealizuar për t'u bërë student.

Kam shkruar e folur shumë për Shkodrën, e, dashje pa dashje, po më rrëmben nostalgjia, por duhet të përqendrohem tek objekti i shkrimit tim.

Kontaktet e para me profesorët e shquar ishte shumë mbresëlënëse: shumë prej tyre më ngjanin me dijetarët e filozofët shumë të hershëm greko-latin apo të tjerë më të vonë, por binin në sy edhe ca pedagogë të tjerë me moshë relativisht të re, që kishe dëshirë t'i shikoje se si sillëshin, si visheshin e si komunikonin. Njëri shquhej për një trup elegant, i veshur thjeshtë e hijshëm, i gjatë e fare pak i kërrusur, mbase nga shtat lartësia, me një natyrë të qetë, flokë të zinj, të ndarë disi përgjysmë, i afrueshëm, modest e komunikues. Admirimi e kërshëria e çdo studenti ishte, përveç mësimeve, të njihnim e studionim edhe për çdo pedagog. Shpejt i mësuam emrin Vehbi Hotit (i lindur me 06.04.1942), e ato perceptimet e para nuk na zhgënjyen as në vitet e mëvonshme.

Veprimtar i palodhur e aftësi organizuese, por edhe shqetësime

Qysh se, në ditët e para e shihnim të merrej edhe me problemet e rinisë; nuk

më kujtohet mirë nëse ishte titullar apo zëvendës, por binte në sy aktivizimi i tij pa tamtame, pa shumë zhurmë e pa rrahje gjoksi, por i gjithë pranuar për cilësitë e tij



pozitive, për shpirtin human, për çka kuptohej e çka na përcillnin edhe studentët e viteve pararendëse. Me sa dukej, ndonëse kishin rezerva për arsye biografie, udhëheqja e Institutit ia njihje zotësinë e aftësitë organizuese, autoritetin e respektin që gëzonte tek rinia, ndaj ia kishin nevojën, duke e pranuar herë hapur e herë "disi fshehurazi" veprimtarinë e tij dobiprurëse.

Nuk dinte të ishte arrogant e mendjemadh, por komunikues, i dashur, respektues e shpirt gjerë, që udhëhiqej nga ndjenja pozitive, gjë që manifestohej në leksione e seminare, në kohën e lirë, në punën prodhuese e në stërvitjen ushtarak. Nuk i kishte falsitete. Mirësinë e sjelljen e kulturuar e kishte në mish e në gjak, se rridhte edhe nga një familje me tradita qytetare, që respektonte çdo shtresë. Këto cilësi ishin pjesë e karakterit e personalitetit të tij, që rritej e forcohej çdo ditë.

E ndiqte pas si hije e zezë "ajo njollë në biografi", për të cilin jo që nuk kishte asnjë ndikim e përgjegjësi, por ishte treguar korrekt duke deklaruar se burri i tezes, bashkë me djalin e madh, ishin arratisur me grupin e nacionalistëve në fundin e nëntorit 1944 (Hafiz Sali Myftia e Fuat Myftia).

Disa komunistë e kolegë të paaftë, mbi jetesën e "besnikërinë ndaj partisë" e shihnin në gërmimin e biografive, duke mos vlerësuar aftësitë e kontributet për vendin.

Përveç mungesës së strehimit, ky ishte shqetësimi më kryesor që e shoqëroi deri në vitet '90.

Edhe atëherë kur e qarkulluan për në

Shkollën e Mesme Pedagogjike të qytetit dhe në Kabinetin Pedagogjik (1977-1981) ishte po i njëjti motiv, por disi i kamufluuar.

Nuk e dekurajuan këto vite, por edhe

këtu u shqua për nivel pedagogjik, shkencor e veprimtar i palodhur. Krahas mësimeve cilësore, ai ngriti Muzeun historik të shkollës, organizoi një sesion shkencor me rastin e 60-vjetorit të themelimit të saj dhe botoi broshurën "60-vjetori i shkollës së mesme pedagogjike 'Shenjaze Juka'".

Me gjithë privacionet e peripecitë, ndjente edhe kënaqësinë e punës; asnjëherë nuk e dha veten as u dorëzua, as i shkoi në mendje të shfrente apo të hakmerrej ndaj studentëve a kolegëve, duke ruajtur drejtpeshimin e vlerat e atëherëshme e të sotme, me shembullin pozitiv e kontribute në rritje.

Edhe në atë sistem, me rregulla e norma strikte e ekstreme, Profetori diti e di të diferencojë e të vlerësojë gjithë ata që i mundësuan shkollimin e lartë për biokimi në vitin 1961 në Tiranë. Prishja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik të asaj kohe, ndikoi edhe në ndërprerjen e studimeve e largimin e studentëve shqiptar që studionin atje.

Në Shqipëri nuk funksiononte degë për psikologji-pedagogji.

Qeveria e atëherëshme vendosi të hapte një degë e tillë duke përzgjedhur një grup të vogël studentësh prej 8 vetash nga vitet e dyta të degëve të mësuesisë së Fakultetit Histori-Filologji (Gjuhë-Letërsi, Histori-Gjeografi, Gjuhë të Huaja) dhe të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (Biokimi).

Në semestrin e dytë të vitit të katërt, Dekanati njoftoi edhe dy studentët e biokimisë që do të ndiqnin degën e re, për t'u paraqitur në një takim në Ministrinë

e Arsimit e Kulturës (MAK); Ministri Thoma Deljana u komunikoi të dyve që, kur të diplomoheshin, do të emëroheshin në Tiranë. (Vehbi Hoti ishte njëri nga këta studentë).

Pas shkollimit, me 1 gusht 1965, filloi punën metodist në sektorin e pedagogjisë në Institutin e Studimeve e Botimeve Shkollore (ISBSH) i hapur për herë të parë në Shqipëri.

Për t'i ardhur në ndihmë familjes, pas një viti, me dëshirën e tij, më 10 shkurt 1966, Vehbi Hoti u emërua pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës (ILPSH).

Edhe sot shprehet me mirënjohje për të gjithë ata, që pas punësimit në qytetin e lindjes, gjykuan e vlerësuan drejt punën e figurën e tij, por edhe të njerëzve të ndershëm, që kontribuuan me devocion për të mirën e Atdheut.

Në prag të vitit të ri shkollor të vitit 1981, me kërkesën e drejtoreshës së Institutit, Dhora Lloja, Sekretari i Parë i Partisë për Shkodrën (nr. 1 për atë kohë), e miraton kërkesën e rikthimit aty ku kishte qenë më parë, duke punuar pedagog i brendshëm deri në vitin 2018.

Sigurisht, përveç mendimit të kolegëve e studentëve, ka qenë edhe mendimi i strukturave drejtuese të Institucionit, kur, tre muaj pas largimit, në 20 vjetorin e hapjes së Institutit, u dekoruan 6-7 punonjës, mes të cilëve edhe Vehbi Hoti, diçka e pa zakonit për atë kohë.

Me të drejtë veçon e lartëson edhe figurën e drejtuesve kryesorë të atij institucioni me vlerë si Mihail Prifti e Dhora Lloja, që iu gjetën pranë e në çdo kohë bënë veprime konkrete ligjore e institucionale për ta vlerësuar e mbajtur si pedagog.

Edhe unë kam pasur fatin e mirë t'i kem pedagogë e drejtues të lartpërmendurit dhe ruaj të njëjtat mendime (si pjesa masive e studentëve e bashkësisë), për të cilët kam shkruar edhe në botimet e mia.

Për këto aftësi e vetë kërkesat për rritjen e nivelit shkencor e pedagogjik po veçoj disa momente që tregojnë shumë :

-Për 16 vite ka qenë anëtar e sekretar i Këshillit Shkencor i ILPSH dhe për 15 vite (1970-77, 1983-1989) sekretar i redaksisë së Buletinit Shkencor, kryeredaktor i serisë së Shkencave të Edukimit të Buletinit Shkencor -periodik i Universitetit të Shkodrës (2004-2017), për disa vite përgjegjës i Katedrës së Psikologji-Pedagogjisë, për 13 vite 1991-2003 dekan i

ditëlindjes (12. 07. 1960) gjithë veprimtarinë e tij intensive në shumë fusha të jetës dhe ja njëra prej tyre: "Me Kryetarin e Rrjetit të Bizneseve Shqiptare për ITALINË, z. Vat Marashi dhe nënkryetarin, z. Hazir Lulaj, në disa qytete të Italisë, disa ditë zyrtarisht takuam mërgimtarët tanë të cilët ushtrojnë biznese dhe trajtuam tema të ndryshme dhe si të veçantë; Investimet Në Trevat Shqiptare!..

Ditari im i datës 23. 08. 2022 vazhdon "Unë kisha kohë që kisha humbur takimet me doktorin për arsye pune e jete in-

tensive këtu në mërgim. Megjithatë unë u ndodha para një befasi lumturuese. Tani kisha bashkë atdhetarin tim që do të kujdesohesh e shëronte mua.

Të nesërmen në orën 08 e 09 minuta vjen me Dr. Biondin që kujdeset për mua dhe Dr. Marashi i shtroi disa mendime te miat mbi gjendjen shëndetësore. Doktorin i pranoi dhe sakaq pyeti: z. Meziu, ju qenkeni mik i ngushtë i doktor Marashit!. Por, ku njihni së bashku?. Unë ju përgjigja me të qeshur: Që prej disa dhjetë vjeç arësh, ne jemi bijë nga i njëjti komb me shume

vlera e histori, jemi të dy shqiptar i thashë doktorit italian. Pas kësaj bisede, dy doktorët u larguan se bashku duke vazhduar vizitat e mëngjesit tek sëmuret e tjerë në pavijon. Unë ndjeja një lehtësim nga sëmundja, ndjeva një krenari dhe kënaqësi që dr. Vat Marrashi, djali nga Gimajt e Shales, dikur i njohur si "Doktori i Ibalës" shërbente me profesionalizëm dhe tashme një mjek i njohur këtu në spitalin e Karezhit - Firenze. Dielli sapo kishte ramun mbi arkitekturën peizazhistë te spitalit të. Unë pacienti Selman dhe dr. Vata,

dy shqiptar tashme miq prej shumë vitesh ishim copëza në peizazhin dhe arkitekturën mrekullueshëm të këtij mjedisi spitalor në Firenze.

Është ky shkrim si një "kartolinë" që përzgjedha të uroj dr. Vat Marashin, birin e Dukagjinit, doktorin e palodhur, humanistin ndërkombehtar. Ai nderon emrin e origjinin e tij, Dukagjinin dhe Shqipërinë.

Selman Meziu, Firenze 12. 07. 2023

Luigj SHYTI, poet, studiues e publicist

Luigj SHYTI, lindur më datën 23 mars 1948, i biri i Gjergjit dhe Ages, në fshatin Theth, të krahinës së Shalës, Dukagjin, .

Është fëmija i parë, prej shtatë fëmijësh i kësaj familje, dy djem e pesë vajza. Të gjithë janë të martuar, dhe kanë krijuar familjet e tyre.

Është nga një familje fshatare e thjeshtë, por, si degë pasardhëse e shtëpisë së përmendur të Lul Gjokës së Gjellajve të Thethit.

U rrit në Theth dhe punoj në Theth dhe në krahinat e fshatrat e Dukagjin deri në moshën pesëdhjetë vjeç, pastaj u vendos në Shkodër, duke vijuar punën si drejtues shkolle në disa shkolla në afërsi të qytetit Shkodër.

Dy fëmijë të kësaj familje, kanë mbaruar arsimin e lartë, tre arsimin e mesëm profesional dhe dy arsimin 8 vjeçar.

Luigji, arsimin fillor dhe 7 vjeçar e mbaroi në Theth, me të gjitha notat 5 pesa, që ishte vlerësimi maksimal për në atë kohë.

I del e drejta e studimit, me bursë të plotë, për të vazhduar shkollën e mesme të përgjithshme në Durrës, me të drejtë studimin, pa ndërprerje, dhe të institutit pedagogjik dyvjeçar në Shkodër. Por kushtet familjare nuk mund ta lejonin të vijonte shkollën.

Luigji, i futet punës në ish kooperativën bujqësore, pas një viti nga mbarimi i shkollës 7 vjeçare, si e mori veten disi më mirë nga ana fizike, për ti ardhur në ndihmë sado pak familjes. Punon direkt në bujqësi, pastaj si zëvendës brigadier, që merrte disa norma fikse, siç thuhej atëherë, sepse ishte nevoja për njerëz sado kudo me më shumë shkollë.

Në vazhdim, për 1.5 vite, punon në vatrën e kulturës po në Theth, me norma kooperative. Pati vlerësime pozitive për organizimin e punës kulturore në fshat, me ato mundësi që ishin.

Ishte koha e punës vullnetare të rinisë. Luigji merr pjesë në hapjen e rrugës së Malësisë së Madhe dhe tarracimin e Kodrave të Lukovës në Sarandë.

Në periudhën kur po zgjerohej arsimiti i detyruar, tashmë 8 vjeçar, në çdo fshat, dhe nuk përballohej me kuadrin mësimor të arsimuar plotësisht profesional, u dha direktiva që të merreshin në punë, provizorisht ata nxënës, edhe të shkollës 7 vjeçare, që kishin pasur rezultate të shkëlqyera. Në këtë grup, Luigji zgjidhet i pari, në Theth, dhe fillon punë si mësues në ciklin e ultë, por jo në fshatin e lindjes.

Ishte kusht i domosdoshëm rritja e aftësive metodike dhe shkencore, prandaj, duhej që për një periudhë katër vjeçare, këta mësues duhet të mbaronin shkollën e mesme pedagogjike pa shkëputje nga puna, për ndryshe do të largoheshin nga puna e mësuesit.

Luigji, sapo fillon punën regjistrohet në shkollën pedagogjike të Shkodrës, pa shkëputje nga puna, dhe e mbaron për tre vjet, me notë mesatare 7.9

Në kohën kur sapo kishte filluar punën si mësues, zgjidhet disa vite rresht sekretar i rinisë i krahinës së Shalës, sigurisht që ishte punë vullnetare.

Dëshira për të rritur nivelin arsimor, kulturor e shkencor, për vete, por edhe për punën që bënte në shkollë e nxiti, dhe realizoi regjistrimin dhe mbarimin e Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, sot Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” me notën mestrarë 7.6, fakultetin e shkencave të natyrës, dega biologji-kimi.

Pas disa vitesh të punës në arsim, dhe pa mbaruar akoma arsimin e lartë, në vitin 1979 emërohet drejtor shkollë në Theth, dhe ka qëndruar në drejtimin e shkollës kudo që ka punuar deri me daljen në pension, duke pasur një ndërprerje, në këtë detyrë, prej një vit e gjysmë në fillim të viteve '90, sipas nenit të famshëm “24/1”, të kodit të punës të asaj kohe.

Luigji ka punuar fort dhe ka pasur rezultate të mira si mësues dhe si drejtues shkolle kudo që ka punuar.

Luigji, ka punuar në Plan, Mguullë, Breglumi-Shalë, Ndërlisa, Abat, Nicaj-Shalë, Theth, Malin Kolaj, Karmë, Gur të Zi, dhe



e shkollës, nuk ka pasur asnjë ngjarje të jashtëzakonshme, si vrasje, plagosje apo aksidente të mësuesve apo të nxënësve, në shkollë as jashtë saj.

Këdo që të takosh në shkolla apo fshatra ku ka punuar, të flasin vetëm fjalë të mira, dhe tregojnë respekt për të.

Luigji, që në rininë e tij, nga mesi i viteve '60, është përfshirë në bashkëpunimin me shtypit lokal dhe kombëtar si me gazetën lokale “Jeta e Re”, revista “Ylli”, gazeta “Zëri i Rinisë”, e më vonë, gazetën “Dukagjini”, “Shkodra”, “Shqipëria Etnike”, revistat “Kumona e së Dielës”, re-

një mënyrë për të botuar një gazetë lokale dhe për të punuar për formimin e një shoqata me qendër Dukagjinin. Qe arritur mirëkuptimi dhe do të dilte së shpejti numri i parë i gazetës që ishte në përgatitjet e fundit, titulli i gazetës po merrte më shumë diskutime. Por trazirat që përfshinë vendin dhe më pas në atë periudhë, e ndërprejnë veprimtarinë e kësaj shoqate dhe ajo u largua duke ndërprerë edhe veprimtarinë e saj për turizmin.

Luigji, duke biseduar edhe me ndonjë shok, ka shtruar që në fundi i vitit 2000 e në 2001, nevojën për krijimin e një shoqate për Dukagjinin dhe vlerat e kësaj zone, hulumtimin dhe propagandimin e tyre. Për këtë pati nxitje nga botimi i librit “Shqipëria-Dukagjini”, i cili sipas Luigjit ishte një libër i pa saktë dhe pa vlerë për këtë krahinë, dhe donte që të bëhej një vlerësim e një refleksion me një grup të organizuar. Kjo nuk u arrit në atë moment, por në vitin 2003.

Luigji bëri reflektimin dhe ja dërgoi Universitetit të Gracit në Austri, personalisht, por edhe e botoi dhe ribotoi në gazetë dhe në një libër të tijën me publicistikë.

Është pjesëtar aktiv në grupin nismëtar të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dhe përgatitjen e dokumenteve të duhura në këtë rast.

Nga fillimi i jetës së saj, dhe për pesëmbëdhjetë vjet rresht ka qenë sekretar i kësaj shoqate.

Është ndër nismëtarët e parë dhe bashkëpunëtor për organizimin e daljen e gazetës “Dukagjini”, dhe që nga dalja e saj është pjesëtar i redaksinës e gazetës e prej rreth dhjetë vjetësh vijon të jenë kryeredaktor i saj.

Luigj Shyti angazhohet në detyrat që i ngarkohen, mendon dhe propozon guximshëm për veprimtari të shoqatës, për Dukagjinin, e më tej, duke marrë përsipër edhe vetë detyra, por edhe ndihmon për realizimin e tyre.

Vazhdimisht ka hulumtuar, mbledhur dhe studiuar, për historinë, kulturën, gjenezën, etnografinë, vlerat natyrore, bimësinë, e të gjitha këto me qendër Dukagjinin dhe dukagjinasin.

Që nga viti 2005 ka botuar dhjetë libra mjaft interesante, si:

1. Dukagjini ka vend për të gjithë, publicistikë, 2005;
2. Gjurmë, syzime etnografike në Dukagjin, 2007;
3. Moj e mira n'ortek të borës, 2009;
3. Lamtumirë mos thuaj, vëllim me poezi, 2011;
4. Dukagjini – rrugëtim në gjenezë, 2014;
5. Duaje emrin tënd, publicistikë, 2019;



në Rragam të Gurit të Zi. Këtu ka dalë në pension.

Në vitin 1987 është vlerësuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë me Urdhrin “Naim Frashri”.

Gjithashtu ka marrë disa certifikata dhe diploma Nderi gjatë punës në arsim, por edhe për punë jashtë shkollore.

Shkollat ku ka punuar Luigji, sidomos si drejtues, ka qenë mbi mesataren e shkollave të tjera paralele, në përparim, disiplinë në punë të mësuesve, dhe në disiplinën të nxënësve, rregull dhe pastërti, mirëmbajtje të shkollës, të tjera.

Gjatë gjithë punës së tij në drejtimin

vista “Gegnia”, gazeta “Korrieri”, “Shekulli”, “Nikaj-Merturi”, me informacione, shkrime problemore, studime, e të tjera. Gjithashtu ka qenë i ftuar në emisione radiofonike e televizione lokale dhe qendrore shpesh herë, ku ka trajtuar kujdesshëm, e dhënë mendime të vlefshme për punën, zonën, qytetin, apo, për historinë, etnografinë, kulturën, turizmin, e të tjera.

Ka përgatitur e publikuar, në mediat e ndryshme të shtypit, rreth 400 artikuj të kategorive të ndryshme.

Që në vitin 1996, Luigji pati biseduar me një shoqatë turistike holandeze që vepronte në ato vite në Theth, për të gjetur

Artisti i munguar, Ikli Punavija, Ish-kryetari i këtij grupi folklorik dhe mjeshtër i Laurisë!

Në Gjirokastrë prej disa ditësh ka nisur të buçasë guri e druri nga ritmi, motivi dhe meloditë e instrumentistëve mbarëkombëtarë. Që nga ansamblet e valleve dhe këngëve dhe motiveve popullore e deri edhe tek vetë instrumentistët apo këngëtarët e pavarur. Buçasin dajret, çiftelia, sharkia, lahuta, lauria e Matit, mandolinat, buçet dhe vetë zëri i polifonisë labe tashmë pjesë e trashëgimisë kulturore botërore. Atje në kalanë historike të Gjirokastrës të mbledhur që nga trevat e Dardanisë, Beshkëve të Namura, bregdetit të Ulqinit, Rrafshit të Shkodrës e Lezhës, alpet shqiptare të Tropojës e Nikaj-Mërtur, malësia e Pukë Mirditës, Mat e Dibër, Iliridë, Tiranë, Fier, Elbasanllinj, Gramshiotë, të Librazhdit, Korçarë o të keqen nenja, nga Skrapari, Berati e sazet e Përmetit, po si mund të mungojnë labët? Pa edhe vetë Gjirokastritë që e kanë në derë tyre. Po kanë ardhur dhe Çamët, po edhe Arbëreshët i kanë ruajtur curlet e tyre veç për të ardhur këto ditë që tanë Gjirokastrës i kanë dhënë ritëm e melodi. Sot Gjirokastra është kryeqyteti i ritmit, melodive dhe valleve!

Në skenë munguan mjaft artistë që

6. Historik i arsimit dhe kulturës në Dukagjin, 2019;
8. Dukagjini – 2012, 2021;
9. Etje, vëllim me poezi, 2021;
10. Fjalë të radha, fjalë të urta dhe shprehje popullore në Dukagjin, 2021.

Luigji është aktiv me pjesëmarrjen e tij në veprimtari të ndryshme të shoqatës, por edhe jashtë saj.

Është nismëtar i Konferencës Shkencore “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”, mbështetur nga kryesia e



fatkeqësisht sëmundja, vdekja dhe pamundësitë të tjera të forta i penguan! Munguan Sherif Dervishi, bilbili Dibran, Laver Bariu Mjeshtri i Madh i sazes Përmetare dhe Imer Neli mjeshtri i fyellit.

Munguan artistët kantautori i njohur

shoqatës, që u zhvillua me 14 tetor 2017, në qytetin e Shkodrës.

Është nismëtar për përgatitjen dhe vendosjen e shtatores së Mehmet Shpendit në qytetin e Shkodrës, në njëqind vjetorin e vrasjes së tij nga ushtria malazeze në Plan, i cili u inaugurua me 15 korrik 2015

Luigji ka hulumtuar dhe përcaktuar lidhjen e At Shtjefen Gjeçovit me Gjeçajt e Thethit, dhe ka mundësuar lidhjen e brezave midis At Shtjefen Gjeçovit dhe At Daniel Gjeçaj, i cili është nga Gjeçajt.

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Du-

matjan Esat Ruka, këngëtarët e njohur Drita Suçi, Fatmira Likmetaj, Sabie Rami e të tjerë.

Por për mua mungesa më e madhe e atij festivali mbetet Ikli Punavija. Asnjë pengesë natyrale, asnjë fatkeqësi për të, asnjë pamundësi! Por një dorë njerëzore, një mungesë e vazhdueshme mbështetjeje, një qëndrim indiferent ndaj tij si artist, instrumentist bëri që Ikli ta braktiste jo vetëm Ansamblin e Matit, por të braktiste edhe Shqipërinë në drejtim të Anglisë! Instrumentist i talentuar dhe drejtues i suksesshëm në krye të Grupi Folklorik Petralba Klos që për herë të parë në qytetin e Bashkisë Klos organizoj dy festivale folklorike mbarëkombëtarë dhe shumë evenimente të ndryshme artistike brenda dhe jashtë vendit e territorit të Shqipërisë.

Që kur e mësova këtë gjë në mes të dimrit, nuk i vura rëndësi. Thashë do të kthehej, do të vijonte përsëri jehonën me meloditë e Laurisë së tij të dashur. Talenti i Iklit është i gjithanshëm, ai është drejtues orkestre, mjeshtër i tingujve të instrumenteve popullore, instrumentist mjeshtër i fyellit, çiftelisë, Laurisë dhe pipëzës. Do të ishte më shumë nder për këdo që do ta mbësh-

teste Iklit, jo për vetë Iklit, sepse Ikli e nderon këdo që i shtrin dorën e bashkëpunimit. Pra, Ikli është artisti i munguar i asaj skene madhështore me mbi 1000 artistë, me dhjetëra interpretime skenike dhe përpara mijëra spektatorëve që shkojnë e vijnë.

Nëse një ditë do të më jepet mundësia, do të kontribuoj që ikli të jetë jo vetëm i përmendur dhe i mbështetur midis rreshtave të shkrimeve të mia, por artisti që duhet të ketë zë dhe përmes instrumenteve të tij të flasë. Heshtja e kujtdo artisti muzikor, është heshtja që duhet t'i dhembë të gjithë shqiptarëve. Ikli është artist që nuk duhet të mungojë, por duhet të meritojë dhe nga zemra shpresoj që për të mos të jetë vetëm pjesëmarrës i dy edicioneve të shkuara, por edhe edicioneve të ardhshme! Përmes kushtimit për Iklit, mesazhi im është që mesa mundësi të kemi dhe me dorën në zemër të mbështesim çdo artist, këngëtar e instrumentist popullor nga të gjitha hapësirat ku banojnë shqiptarë dhe të gjithë artistët që flasin dhe shkruajnë shqip.

Ermal Lala,

Tiranë, më 28 qershor 2023

kagjini” e ka shpallur Luigjin “Nderi i Shoqatës”, me vendim nr. 141, me 10 maj 2013

Gjithashtu e ka vlerësuar me titullin “100 vjet Arsim e Kulturë në Dukagjin”, me vendim nr. 235, me 7 shtator 2017 dhe “Mirënjohja Martin Camaj”, me vendim nr. 239, me 20 mars 2018

Shoqata Atdhetare “Dukagjini” bashkë me tri shoqata të tjera në Shqipëri dhe Kosovë i kanë shpallur Gjysten, Luigjin, Kolë Çardakun, Prelë Shytanin dhe Aleks Dushin, “Pishtarë të Arsimit” në vitin

2018.

Periodha e deritashme e pensionit, është një periudhë pune intelektuale e vazhdueshme e Luigjit, i cili po punon mbi materialet e mbledhura, e së shpejti do të jenë gati edhe më shumë se një libër për botim.

Luigj Shyti është i martuar me Gjyste Shytin Gilaj nga fshati Lotajt e krahnës së Shalës. Kanë lindur dhe rritur 5 fëmijë. Të gjithë janë të martuar dhe kanë krijuar familjet e tyre. Janë të arsimuar të gjithë, kush me të mesmen dhe kush me

të lartën. Njëri nga djemtë është mjek në spitalin universitar në Gjenova, Itali. U gëzohen 8 nipave dhe mbesave, natyrisht që presin edhe të tjerë.

Gjystja e Luigji janë një çift shumë i pëlqyer dhe i vlerësuar nga kolegët e punës dhe nga shoqëria në tërësi.

Gjystja ka mbaruar shkollën për mësuesi dhe pas një periudhë pune 42 vjeçare në arsim, ka dalë në pension.

Në punën familjare dhe realizimet shtetërore e shoqërore të Luigjit, Gjystja ka qenë ndihmëse dhe mbështetje konkrete e vijueshme, prandaj Luigji është ky që është.

Ndue Sanaj



Nga e majta në të djathtë Aleks Dushi, Kolë Çardaku, Gjyste Shyti, Luigj Shyti e Prele Shytani të nderuar me titullin e lartë “Pishtar i Arsimit”, në muaqin nëntor 2018

Deri kur kështu? Ku je Anton Çeta, shumë po na mungon?!

"O njerëz! / Zgjidhni rrugën e jetës, zgjidhni rrugën e dashurisë njerëzore, të shpresës. / Zgjidhni rrugën e besimit tek e nesërmja, zgjidhni rrugën e së mirës. / Ju përket juve e vetëm juve ta zgjidhni"

Leo Bascagli



Shkruar nga: FRAN GJOKA

Gjakmarrja në Shqipëri vijon si qëmoti. Gjakmarrja është një fenomen mjaft i përhapur po aq sa edhe i përfolur, sidomos në zonën e veriut. Shumë studime janë realizuar lidhur me këtë fenomen negativ, shumë analiza janë bërë dhe shumë statistika janë hartuar megjithatë ende nuk janë ofruar alternativa për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare kësaj plagë shumëvjeçare të shoqërisë sonë. Gjakmarrja është një fenomen tipik i shoqërive njerëzore ku ligji nuk ka forcë ose shteti nuk e quan përgjegjësi të vetën shuarjen e konflikteve të tilla. Në jetëgjatësinë e këtij fenomeni nuk ka ndikuar vetëm pasiviteti i organizmave shtetërore, por edhe mungesa e ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare e, mbi të gjitha, asaj të zonave veriore, ku rëndom zbatohet Kanuni, por që këto ligje të vjetra kanunore janë vetëm mbetje të pavlefshme të një mentaliteti shekullor. Kanuni është ai që i ka dhënë jetë dhe e ka ushqyer gjakmarrjen ndër vite. Ky është një slogan mbi të cilin njerëzit nuk duan të thellohen shumë dhe shumica në thelb nuk e njohin dhe nuk e zbatojnë atë, por flasin dhe veprojnë sipas ligjeve kanunore. Në pamje të parë, Kanuni aq i përfolshim, aq i egër dhe aktualisht aq i zhvlerësuar në hijeshinë e tij shekullore, ka nisur të funksionojë si një meritë e një mendjemprehtësie të lashtë. Kanuni, fatkeqësisht, në vend që të vlerësohet si trashëgimi kulturore, ai urrehet dhe zbatohet sipas interesave personale. Në vend që të ruhet si një pasuri e kombit shqiptar, e cila ka pasur një rol specifik dhe të rëndësishëm në funksionim e shoqërive të disa shekujve më parë, ai përdoret akoma edhe sot në shekullin XXI. Ndërkohë me qindra të ngjuar presin ditën e shpagimit dhe ditën e ekzekutimit, as shteti, as shoqëria nuk kanë gjetur asnjë rrugëdalje për të kapërcyer këtë dramë që po mban peng mijëra banorë të vendit tonë, qindra fëmijë jo vetëm nuk kanë mundësi të ndjekin shkollat, por rrezikojnë të mbesin me pasoja të rënda psikologjike për jetën.

Kanuni nuk është film, por realitet i egër e dëshpërues

Gjakmarrja e sotme shqiptare jo vetëm po shkatërron aktualisht mijëra jetë, por psikologjikisht ka shkatërruar peizazhin e traditës, duke krijuar në mendjen e njerëzve humnera të shumta tradicionale dhe kulturore. Si të gjithë edhe unë kam dëgjuar në përgjithësi për këtë fenomen dhe ndjeshmëria ime nuk ka qenë aq e fortë sa është dhe vazhdon të jetë tani. Vazhdimisht kam dëgjuar të flitet për fëmijë të ngjuar, prindër të privuar nga të drejtat themelore të njeriut, nga e drejta për të qenë të lirë, e megjithatë nuk kam mundur ta kuptoj realisht ndikimin shumë të fuqishëm të këtij problemi aq të prekshëm në vendin tonë. Vetëm pasi kam qenë pjesë aktive e shumë projekteve në favor të familjeve të ngjuara, vetëm pasi kam qenë një njohës i drejtpërdrejtë i individëve, të cilët janë pjesë e kësaj fat-


të ngjuara, kam dëgjuar rrëfimet e tyre të sinqerta, të dëshpëruara, rrëfime nga prindërit, rrëfime nga fëmijët, të cilët me lotë në sy, me pafajësinë e tyre dhe me shpresën që një ditë çdo gjë të jetë ndryshe, duke besuar tek shteti dhe tek shoqëria të mund të gëzojnë të drejta të njëjta me bashkëmoshataret e tyre. Të dëgjosh të flitet për gjakmarrjen dhe të jesh njohës aktiv, ndërhyrës i drejtpërdrejtë në këtë plagë të shoqërisë janë dy gjëra krejt të ndryshme. Fakti që kam marrë pjesë në shumë tryeza të rrumbullakëta, takime, diskutime dhe trajnime të ndryshme, në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, kam marrë pjesë në projekte të hartuara më ndihmën e tyre, më ka bërë shumë më të ndjeshëm ndaj këtij fenomeni. Shumë është abuzuar me termin dhe përhapjen e fenomenit të gjakmarrjes, aq sa njerëzit ndoshta janë lodhur së dëgjuari, por unë mendoj se asnjëherë

lin e rëndësishëm që ka punonjësi social në mbështetjen morale dhe psikologjike ndaj tyre. Jam i mendimit se sa më shumë të përflitet, të shqyrtohet dhe të diskutohet në median e shkruar dhe vizive, në takime dhe në konferenca ky problem, aq më tepër shoqëria do të ndërgjegjësohet dhe do të bëhet më e ndjeshme kundrejt kësaj plage të rëndë të shoqërisë dhe do të jenë më të motivuar për të ndërmarrë hapa konkret.

Çfarë thotë Edit Durham për kanunin shqiptar?

Gjakmarrja, në konceptin e ngushtë, është trajtuar si një hakmarrje "gjak për gjak" midis dy familjesh, apo dy personash, ku të afërmit e viktimës përpiqen të hakmerren për vrasjen e tij, duke vrarë autorin apo dikë nga familja e tij. Një familje e tërë mban përgjegjësi për veprimin e cilitdo anëtar të saj. Edhe studiuesja e njohur Edith Durham, gjatë udhëtimit nëpër Shqipërinë e Veriut, e ka vënë re këtë fenomen të tmerrshëm anti-njerëzore, por që zbatohet nën trysinë e disa ligjeve kanunore të hekurta, shpesh edhe krahinore. Madje ajo kishte takuar edhe dy gjakësorë, të cilët sapo kishin marrë gjakun. Ja si shkruan për njërin prej tyre: "...Ishte një djalosh i gjatë, zeshkan, që dukej ende fëmijë. I heshtur dhe i tronditur, dukej sikur e kishte vënë poshtë fati...". E fati i tij tashmë dihej. Por duhet ditur se në periudhën kur shkruan studiuesja e njohur vërtet kishte hakmarrje, por të gjitha veprimet bazoheshin në Kanun, asgjë jashtë kodeve zakonore. Për këtë mjafton të citojmë momente nga kujtimet e saj: "...në Kanunin e Lekë Dukagjinit ka rregulla, të cilave u duhet bindur. Sipas tij, edhe burri, i cili ka gjak borxh, në rrethana të caktuara, nuk mund të vritej".

Ai që ka gjak dhe ai që detyrohet të paguajë gjak bëjnë një armëpushim, mund të betohen për paqe gjersa të mblidhen të korrat ose në rast lufte. Ja pra, që në rrethana të caktuara kuvendi është i detyruar. Ja një fakt tjetër nga e njëjta autore: "... Një natë e kalova në shtëpinë e njërit që ishte në gjak. Vëllezërit, të cilët na pritën, dolën dhe bërtitën në të katër anët: "Kemi miq!... pas kësaj u kthyen për të festuar në siguri një mbrëmje të qetë". Edhe pse shumë aspekte të hakmarrjes ngajnë me konceptin e drejtësisë, hakmarrja ka një fokus më të padrejtë dhe ndëshkues në krahasim më të. Ndërsa drejtësia në përgjithësi nënkupton veprimet e ndërmarrja dhe të mbështetura nga një sistem i etikes, ose në emër të etikës së shumicës. Hakmarrja në përgjithësi nënkupton veprimet të ndërmarrja nga një individ ose grup i ngushtë personash, jashtë kufijve të sjelljes gjyqësore ose etike njerëzore. Fenomeni i të miturve "të ngjuar" dhënë ndryshe në gjuhën letrare



keqësie, vetëm pasi kam parë dhimbjen e të mohuarit të të drejtës për të jetuar, arrija të kuptoj se sa thellë qëndron problematika e këtij fenomeni në jetën tonë. Kanuni nuk është film, por realitet i egër e dëshpërues.

Kam parë mënyrën se si jetojnë familje

nuk është e tepërt të trajtohet dhe analizohet kjo problematike, po ashtu asnjëherë nuk është vonë për të ndërmarrë hapa konkrete në zgjidhjen e këtij fenomeni shqetësues. Duke iu referuar pasojave negative të këtij fenomeni, mbi të gjitha atyre psikologjike, duhet të theksojmë ro-

“të mbyllur në shtëpi”, është i gjerë dhe i ndryshëm dhe mbi të gjitha nuk mund të analizohet i vetëm, sepse ai bën pjesë në një sistem shoqërorë të vjetër, që akoma sot mbijeton në Shqipëri. Nuk mjafton që të hysh në realitetin e qindrave fëmijëve të mbyllur brenda katër mureve pa ndërë ndërgjegjen tënde të rebelohet, siç ndodh shpesh me ne shqiptarët. Duhet të hysh brenda problemit, ta përjetosh atë me të gjithë kompleksitetin që ai paraqet dhe të ndërgjegjësohem, duhet të nisemi nga kanuni për t’u orientuar në reflektimin tonë, jo me një përçarje të tipit juridik, por duke u përpjekur të kuptojmë, para së gjithash, se çfarë është ajo që e bën këtë “kod” të vjetër me shekuj, diçka aq të rëndësishme, nga e cila s’mund të heqin dorë shqiptarët.

Po gratë dhe fëmijët çfarë faji kanë?

Në se merr instiktiven humane të vizitosh një familje të ngjuar do të konstatoosh se ajo jeton në kushte të papërbalueshme për jetën, duke u ballafaquar me mungesa të shumta të karakterit ekonomik, shëndetësor, edukativ e të tjerë. Më të prekurit në këtë rast padyshim janë gratë dhe fëmijët, si pjesa më e pambrojtur e shoqërisë sonë. Gratë në familjet e ngjuara nga gjakmarrja janë viktimat e vërteta të saj. Ato, megjithëse janë “të lira”, pasi tradita dhe kanuni nuk lejon vrasjen e tyre për gjakmarrje, janë pjesë më e persekutuar dhe e dhunuar e familjes. Ato duhet të kryejnë të gjitha punët e shtëpisë në mungesë të burrave, të cilët janë të detyruar të qëndrojnë të mbyllur. Po ashtu edhe fëmijët sidomos ata meshkuj, janë një tjetër viktimë e dhimbshme e gjakmarrjes. Ata duhet të jetojnë plotësisht të izoluar në shtëpitë e ngjuara, gjë që do të thotë të mos shkojnë në shkollë, të mos luajnë me moshatarët e tyre, të mos argëtohen. Të rriten me psikozën se ata duhet të mbrojnë familjen, duhet ta mbrojnë nderin e saj, duhet të vrasin të tjerët për gjakmarrje dhe duhet të vriten edhe vetë. Në këto kushte fëmijët rriten të varfër, të pashkolluar të egër dhe hakmarrës. Një fëmijë 11-vjeçar, i quajtur Nikolin, i intervistuar nga BBC, familja e të cilit ka qenë në grindje me një tjetër për 30 vitet e fundit, thotë se ai ka ëndërr që një ditë të shkojë në shkollë. “Unë e imagjinoj se është një vend i bukur, me libra, karrige, dhe një dërrase të zezë. E imagjinoj shkollën të mbushur me fëmijë të tjerë të moshës sime që mësojnë, luajnë dhe këndojnë...”. Dhe pas këtyre meditimeve nga brenda qenies së gjithkujt thërret protesta? Po gratë dhe fëmijët çfarë faji kanë? Po kjo shoqëria jonë që traumatizohet dhe therorizohet nga lajmet e faqeve të para të gazetave dhe lajmet e televizioneve, çfarë faji ka?

Spektri i problemeve sociale shqetësuese për shoqërinë shqiptare sot është mjaft i gjerë, por ajo që është bërë një plagë e rëndë, jo vetëm për veriun e Shqipërisë dhe po merr jetë njerëzish të pafajshëm është gjakmarrja dhe ngujimi i fëmijëve nga krimi i saj. Gjakmarrja, ky fenomen i ndaluar me dhunë nga regjimi komunist, por që arriti të rishfaqej hapur në periudhën e tranzicionit kryesisht për rrjedhojë të shpërthimit të depove të armatimit gjatë trazirave të vitit 1997, armatosjes së popullatës dhe mangësive në

legjislacionin shqiptar, solli për pasoja edhe zgjidhjen e konflikteve në vetëgjyqësi. Pra, secili duhet të gjejë veten në nenet e këtij kodi shoqëror në kushtet e mungesës së gjithë strukturave qeveritare dhe shtetërore. Shqiptarët të përkulur vite me radhë nën thundrën e sistemit diktatorial vërtetuan se kishin humbur nocionet “besë”, “fe” dhe “tradite”. Ndryshe s’ka si të ndodhte që në një gazetë të fundvitit 1998 të shkruhej me shkronja të mëdha: “... Në veri 764 familje janë në gjak dhe mbi 1120 janë të ngjuara në kulla”. Kjo është një dobësi e strukturave shtetërore, sepse atje ku nuk vepron ligji, duhet të veprojë Kanuni e atje ku nuk vepron Kanuni dhe as ligji, vepron anarkia. Deri kur kështu?

Shteti, institucionet dhe shoqatat bëjnë vetëm statistika!? Ku jeni Anton Çeta, shumë po na mungon?

Fenomene të tilla ndodhën edhe në qarkun e Lezhës e më gjerë. Pati vrasje, hakmarrje të vjetra e të reja, grindje, zënie e ngatërresa. Karakteri i tyre ishte i ndryshëm. Shumë vrasje u bënë për hakmarrje, por pati edhe për çështje pronësie, çështje nderi dhe zënie të rastit ose, siç thuhet sot, “motive të dobëta”. Kështu mjaft individë nuk patën parasysh as rregullat më elementare të Kanunit. Shumica e atyre që vrasin, Kanunin e konsiderojnë si kompleks rregullash, ku thuhet se “po vrave, të vrasin”, pa marrë parasysh pasojat e tjera që vijnë më pas si djegien e shtëpisë, dëbimin nga fshati, gjogat e ndryshme dhe në varësi të aktit të kryer mund edhe të... fatesh. Por në të vërtetë gjatë kësaj periudhe Kanuni u përdor gabimisht si sfond nxitës për të marrë gjakun.

Ky krim i shëmtuar ka prekur tashmë rrethin apo prefekturën e Shkodrës, zonën veriore të vendit dhe që nuk ka masë gjykimi kur arin të ndalet edhe tek fëmijët apo gratë, duke shkelur rëndë parimet bazë të Kanunit. Çfarë janë këto doke dhe tradita mesjetare që po qeverisin shoqërinë shqiptare sot, sidomos në veri, në mënyrë barbare, ku ndihet zgjedha e tyre e rëndë antishoqërore mesjetare. Ato po pengojnë e dëmtojnë rëndë shoqërinë tonë të eci në rrugën e demokracisë, prandaj puna për parandalimin e krimit është një detyrë e mprehtë dhe aktuale e shoqërisë civile, e ligjit dhe e shtetit. Familjet, kur përballesh me problemin e ngujimit, tentojnë të fshihen dhe të mos shfaqen përpara autoriteteve shtetërore apo përfaqësuesve të shoqatave të ndryshme humanitare. Ato shpesh i ndërrojnë vendbanimet e tyre dhe nuk e tregojnë vendodhjen e re, nuk i regjistrojnë fëmijët në shkollë e të tjera. Ky fakt e bën më të komplikuar evidentimin e tyre dhe shpesh të pamundur nxjerrjen e të dhënave të sakta. Të dhënat dhe shifrat e nxjerra nga strukturat shtetërore apo nga organizatat e interesuara për këtë problem shpesh mund të fryhen apo zvogëlohen për qëllime të ndryshme.


Zgjidhja e konflikteve kërkon një shqyrtim kritik të alternativave të ndryshme dhe të mundshme si dhe një angazhim me veprime konkrete të njerëzve, shoqërisë apo dhe shtetit. Nëse përpjekjet dhe përkushtimi i atyre njerëzve që merren me pajtim dhe shuarjen e konflikteve bazohen në njohuri dhe vlera, atëherë mund të themi se ata përfshihen në një veprim shoqëror të dëshirueshëm dhe rezultatet mund të jenë të prishmë. Në këtë mënyrë, e gjithë kjo shënon një rrugë të suksesshme drejt rritjes së vlerave pozitive të personalitetit të këtyre njerëzve, e cila pastaj do të përdoret për pajtim dhe ndërmjetësim. Sa nevojë kemi për Anton Çetën? Na duhet shumë sot ai njeri me shpirt të madh dhe human. Ky popull ka nevojë për shumë Anton Çeta. Ata na duhen në shtëpi, në fis, në rrugë, në fshat, në lagje, në qytet, në krahinë...

Gjendja aktuale shoqërore në veri dhe ne jug të Shqipërisë është sot shqetësuese dhe akoma nuk duket se po gjendet një zgjidhje efikase, ose më mirë akoma nuk duket se po bëhen përpjekje serioze dhe konkrete. Kandidatët për kryetar bash-

të shumtën e rasteve në zbatimin e kodit penal dhe shqiptarët e kanë të vështirë të lejojnë padrejtësitë dhe hakmarrjen, e shohin si zgjidhjen me efikase zbatimin e normave tradicionale. Pavarësisht numrit të madh të pajtimeve nga misionet e pajtimit që veprojnë në disa zona, numri i ngujimeve vjen gjithmonë në rritje dhe akoma nuk shihet diçka konkrete. Pasojat e ngujimit nuk janë vetëm ekonomike, por edhe psikologjike dhe populli shqiptar do të vuajë plagët e saj ndoshta për shumë kohë. Sa fëmijë mbesin analfabetë, sa jetë këputen në mes e sa njerëz bëjnë sikur asgjë nuk ndodh? Fenomeni i të “Të ngjuarit” përbën një nga problemet kyç të Shqipërisë, por që çuditërisht shteti ynë po bën veshin e shurdhër dhe gjithçka mbetet në dorën e shoqatave dhe organizatave joqeveritare humanitare. Lind pyetja: -A janë kontributet e tyre të mjaftueshme? Njohja e gjendjes aktuale të vrasjeve të ndodhura, të familjeve të ngjuara, problemeve psikosociale apo ekonomike të tyre e bën më të dobishëm dhe të pazëvendësueshëm rolin e punonjësit social. Megjithatë punonjësi social

nuk mund të punojë vetëm, prandaj duhet para së gjithash ndërhyrja e shtetit shqiptar në zgjidhjen e kësaj çështje. Shoqatat dhe organizatat vazhdojnë të bëjnë përpjekjet e tyre, por nuk mjaftojnë.

Statistikat tregojnë se numri i familjeve të ngjuara, numri i vrasjeve të kryera në emër të gjakmarrjes, numri i fëmijëve që nuk ndjekin shkollën po vjen gjithnjë duke u rritur. Kjo është frikësuese, por në të njëjtën kohë dhe paralajmëruese për masat imediate që duhet të merren në të ardhmen. Populli shqiptar duhet të mobilizojë gjithë potencialin fizik e mendor dhe intelektual për ndalimin e gjakderdhjes, kësaj epidemie që vjen nga thellësitë e shekujve për të sfiduar kulturën dhe qytetërimin tonë të sotëm si shtet evropian. Partitë, organizatat e shoqatave duhet të udhëhiqen nga interesat kombëtare dhe



bazamenti i këtyre interesave, padyshim është forcimi i unitetit kombëtar. Vallë a mund të ketë unitet dhe bashkim, kur ne shqiptarët nuk jemi tolerantë e për rrjedhojë vrasim njëri-tjetrin? Rinia shqiptare, pjesa më vitale e kombit tonë, gjaku i së cilës është tepër i çmuar, duhet mësuar që t’i ruajë armët për të mbrojtur trojet e të parëve dhe jo për të mbjellë hakmarrjen. Kërkoni dashuri dhe do ta gjeni. Arma më e fuqishme në shoqërinë tonë të sotme është dashuria. Ne shqiptarët nuk kemi qenë e as nuk jemi barbarë. Bota i njohu paraardhësit tanë, si burra të besës e bujarisë. Duhet të jemi trashëgimtarë të denjë të tyre. Kurse, qeveritarët, parlamentarët, institucionet dhe njerëzit e ligjit “s’duhet të lajnë duart si Pilati!”, sepse, duket se ata po mendojnë më shumë për rrogat e tyre, sesa për shqiptarët që po vriten rrugëve dhe shesheve të Shqipërisë apo që po marrin rrugën drejt arratisë...!

Shoqata të ndryshme janë përpjekur që nëpërmjet veprimtarive sensibilizuese të bindin shqiptarët se konfliktet zgjidhen nga shteti dhe se nuk është çështje vetëm e tyre, kështu që duhet të besojnë në fuqinë e ligjit të shtetit dhe duhet të pranojnë format e tij të zgjidhjes, të besojnë në drejtësinë e tij. Meqë shteti ka dështuar në

Gjelosh Rushaj humb jetën aksidentalisht në punë



Gjelosh Rushaj po punonte në riparimin e segmentit të rrugës së fshatit Planit, që po vazhdonte iniciativën e vëllait, Pjetri (që humbi jetën me djalin e tij, Jasonin, në prrojnë e That), i cili u mbështet nga banoret e fshatit Plan-Gjuraj dhe dashamire për të siguruar fondet. Kjo rrugë është jashtë të gjitha parametrave, shkaku që solli edhe aksidentin me pasojë vdekjen e Gjeloshit. Rruga e amortizuar dhe ngushtë ka krijuar shembje dhe kami-onçina ka ra në humnerë. Fale familjarëve, punëtorëve dhe policëve u arrit nxjerrja në rrugë e Gjeloshit dhe ardhje në kohe e Helikopterit bene që ai të dërgohet në Spitalin e traumës në Tiranë.

Jetën e krijuan Zoti dhe Ai e ka ne dorë. Lum njeriu që e në fundin e kësaj jete

tokësore merr me vete emrin e mire, të cilin e ka nderta me nder, burrni, dashni dhe fisnikëri. Gjelosh (Loshi) Rushaj jetoi dhe e dha jetën që Dukagjini të mos braktiset. Ketë mesazhe Gjeloshi na dha ditën që përfundoj rrugën për në Qytezën e Boksit, të cilën e kishte nisur Vëllai i ndjeri Pjetri.

Gjelosh faleminderit që jetove, punove e dhe jetën për Dukagjinin. Shpirti juaj pushoftë në Paqe, me Krishtin së bashku me Pjetrin, Jasonin dhe të gjithë të vdekurit në rrugën e Dukagjini, lutuni për Ne. Lutuni Zotin, që kjo rrugë të mos ketë më viktima!

Në ceremoninë mortore të Gjelosh Rushajt morën pjese mbare dukagjinasi, morën pjese Kryesia e shoqatës atdhetare

“Dukagjini”, me ne krye Ndue Sanaj e Gjergj Leqejza, anëtarët e grupit drejtues për rrugën e Dukagjinit, më në krye Mark Rupen, Kole Sukullari e Mhill Shkamin.

Nis me 1-minut heshtje filloi mbledhja e Këshillit të Bashkisë Shkodër, në nderim të Gjelosh Rushaj i cili humbi jetën tragjikisht në një aksident rrugor në rrugën e Dukagjinit. Kërkesa u bë nga këshilltarja zonja Eliona Shkreli. Faleminderit Eliona Shkreli!

Lamtumirë vëllai e miku i jone Gjelosh Rushaj!

Redaksia

Kuriozitet: Lugina e Vdekjes, ja ku ndodhet vendi më i nxehtë në planet, temperatura shkoi 54°C

DITA, 16 Korrik, 2023

“Lugina e vdekjes” është vendi ku regjistrohen temperaturat më të larta në të gjithë planetin. Ndodhet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konkretisht në Kaliforninë juglindore.

Të shtunën, “Lugina e Vdekjes” regjistroi temperaturën më të lartë në botë: 54 gradë. Turistët aventurierë nuk e humbën rastin të vizitonin parkun kombëtar për të prekur nga afër një moment me thyerje rekordesh.

Rekordi i të gjitha kohërave në Luginën e Vdekjes ku u regjistrua 56.6 gradë celsius u shënua në korrik 1913. Pavarësisht temperaturave të larta, një ranger i parkut thotë se vapa nxit turizmin në zonë. Por asnjë person nuk mund të qëndrojë më shumë se 10 deri në 15 minuta jashtë mjetit pasi nxehtësia mbyste është e

papërbalueshme për njeriun.

Është një vend ku nuk gjen dot hije. Edhe automjetet shfaqin jo pak probleme kur kalojnë në “Luginën e Vdekjes”. Teknologjia shpesh nuk punon prandaj e vetmja mbështetje për të bërë turizëm në “Luginën e vdekjes”, është harta. Ndërsa termostati jozyrtar jashtë Qendrës së Vizitorëve tregonte temperatura ekstreme, nxehtësia nuk i dekuraçoi aspak turistët e huaj të përjetonin një përvojë që ndodh një herë në jetë.

“Lugina e vdekjes” u shpall Park Kombëtar në vitin 1994. Mbi milion njerëz e vizitojnë atë çdo vit për të soditur peizazhin e saj të shkretëtirës dhe për të provuar se si është të kalosh disa orë në vendin me temperaturat më ekstreme të planetit.



REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

SHËNIM:

Të nderuar lexues të gaztës “Dukagjini”, ju kërkojmë ndjese, që në numrin e kaluar të gazetës “Dukagjini”, të muajit qershor 2023, për artikullin “Profesor Doktor Vuksan Kola”, në faqen 13 të saj, janë bërë dy gabime krej pa dashje. Nuk është fotografia e familjes së profesor Vuksanit dhe nuk është shkruar emri i autorit të shkrimit. Emri i autorit ka qene Ndue Sanaj. / REDAKSIA



Familjarisht me pushime në Ishullin Santorini, Greqi, 12 qershor 2017



Në një veprimtari nderkombetar, në Firence- Itali, 3 prill 2009



Mundësoi Botimin:
AGIM HASANAJ
me banim në SHBA